



TË LËNË PAS DORE!

TRAFIKIMI I BURRAVE

DHE DJEMVE

NË SHQIPËRI

TIRANA, 2015



Të lënë pas dore!
Trafikimi i burrave
dhe djemve në Shqipëri

2015

Autor: Organizata “Të ndryshëm & Të Barbartë”

Grafika: Elzana Agolli

ISBN

Ky studim publikohet me mbështetjen e *King Baudouin Foundation* dhe të Lotarisë Kombëtare Belge

Pikëpamjet shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të *King Baudouin Foundation*.

Të gjitha të drejtat e këtij studimi i janë të rezervuara organizatës “Të Ndryshëm & Të Barbartë”.

Janar 2015

I. Falenderime

Ky publikim realizohet me kontributin e çmuar financiar të *King Baudouin Foundation (KBF)*, të cilëve u shprehim mirënjohjen tonë të thellë. Dëshirojmë të falënderojmë në veçanti Fabrice de Kerchove, Menaxher i Projektit për Programin e Ri/Integritit të Viktimave të Trafikimit (TVRP) në KBF, për mbështetjen e tij të vazhdueshme në përpjekjet tona për të asistuar ri-integrimin e viktimave të trafikimit.

Falenderojmë konsulentin Valbona Lenja dhe punonjësën e D&E Elvis Popaj për kontributin e dhënë në realizimin e studimit.

Vlerësim dhe mirënjohje e thellë për Rebecca Surtees, Hulumtuuese e lartë në *NEXUS Institute*, për këshillat dhe sugjerimet e kujdesshme për tekstin e këtij studimi. Falenderojmë edhe Laura S. Johnson, Hulumtuuese në *NEXUS Institute*, për ndihmësën e saj me redaktimin.

Dëshirojmë të falënderojmë të gjithë personat e intervistuar për këtë studim për gatishmërinë për të folur rreth përvojave të tyre, për bashkëpunimin dhe kontributin e rëndësishëm që na mundësoi të kuptonim më mirë sfidat me të cilat përballen meshkujt e trafikuar në Shqipëri.

Falenderim i veçantë për anëtarët e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik, veçanërisht menaxherët e rasteve nga “Tjeter Vizion” dhe Qendra Psiko-sociale “Vatra”, për informacionin e dhënë në bazë të përvojave të tyre.

Falenderojmë thellësisht edhe migrantët e intervistuar për këtë studim, që ishin të gatshëm të ndanin me ne hollësi të rëndësishme nga jeta e tyre dhe përvoja e migrimit.

Së fundi, dëshirojmë të shprehim mirënjohje për të gjithë personat e trafikuar—si ata që janë ri-integruar edhe ata që janë ende duke luftuar për të ecur përpara me jetën e tyre. Ne e admirojmë këmbënguljen, kurajon dhe shpresën tuaj dhe urojmë që ky studim të ndihmojë në të ardhmen për një përgjigje dhe reagim më të mirë për personat e trafikuar.

Mariana Meshi
Drejtoreshë Ekzekutive
Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

2. Shkurtime

KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ARSIS	Shoqata për Mbështetjen Sociale të të Rinjve
PSH	Policia e Shtetit
D&E	Të Ndryshëm & Të Barabartë
FBSH	Fëmijët e Botës Shqipëri
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GRETA	Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
KBF	King Baudouin Foundation
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
NJL	Njësi lëvizëse
KKAT	Koordinatori Kombëtar Anti-trafik
KKSA	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
VPT	Viktima Potenciale të Trafikimit
AP	Autoriteti Përgjegjës
SHKEJ	Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën
ISHP	Inspektorati Shtetëror i Punës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
PRVT	Programi i Ri-integrimit të Viktimave të Trafikimit
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
VeT	Viktimat e Trafikimit

Përmbajtja

1. Falenderime	3
2. Shkurtime	5
3. Përmbledhje ekzekutive	7
Hyrje	9
4. Metodologjia e hulumtimit dhe kufizime	11
5. Meshkujt e trafikuar: jeta dhe përvojat e trafikimit	14
6. Identifikimi i meshkujve të trafikuar në Shqipëri – modele dhe barriera	30
7. Barrierat për identifikimin e meshkujve të trafikuar në Shqipëri	33
8. Asistenca për viktimat meshkuj të trafikimit – nevoja dhe vështirësitë	49
8.1 Strehim dhe akomodim	49
8.2 Siguria	50
8.3 Asistencë psikologjike	50
8.4 Ndihma mjekësore	53
8.5 Ndihma ligjore	54
8.6 Arsimimi, shkollimi dhe trajnimi profesional	55
8.7 Ndihma për punësim	56
8.8 Rritja e aftësive për jetën dhe plotësimi i nevojave sociale	57
8.9 Ndërmjetësimi me familjen	59
8.10 Asistenca për fëmijët apo motrat dhe vëllezërit e VeT	60
9. Vështirësitë në dhënien e ndihmës viktimave meshkuj të trafikimit	61
10. Konkluzione dhe rekomandime	64
10.1 Identifikimi	64
10.2 Asistenca	65
11. Referenca	67
12. Shtojca	69

3. Përmbledhje ekzekutive

Ky studim vlerësues u krye në kuadrin e projektit “*Rritja e përpjekjeve për ri-integrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri*”, mbështetur nga Programi i Ri-integrimit të Viktimave të Trafikimit (PRVT) në Ballkan me mbështetjen financiare të KBF.

Ky dokument përpiqet të hedhë dritë mbi një çështje pak të studiuar në Shqipëri apo në rajon: trafikimin e meshkujve. Burimet për informacionin e këtij studimi përfshijnë përvojën e *D&E* të akumuluar gjatë dy viteve në përpjekjet për identifikimin dhe ndihmën për viktimat meshkuj të trafikimit; analizat dhe dosjet e rasteve të 23 viktimave meshkuj të trafikimit të asistuar në kuadrin e programit të ri-integrimit; 16 intervista të kryera në pikat e kalimit të kufirit në Kapshticë dhe Rinas me meshkuj migrantë të parregullt; intervista me aktorë kryesorë në Shqipëri; një pyetësor i plotësuar nga agjenci dhe profesionistë; si dhe rishikim literature.

Studimi eksploron dhe analizon në thellësi situatën e trafikimit të meshkujve në Shqipëri, duke theksuar pengesat dhe vështirësitë e hasura për shkak të paragjytimeve gjinore dhe tabuve kulturore në lidhje me trafikimin e meshkujve.

Studimi eksploron më në thellësi përvojën e *D&E* dhe të partnerëve të saj të Koalicionit gjatë këtyre dy viteve të asistencës për viktimat meshkuj të trafikimit.

Analizat e dosjeve të rasteve për 23 personat e asistuar dhe 3 intervistat tregojnë për dy prirje të përgjithshme të identifikimit të meshkujve si *VeT* në bazë të përvojës së asistencës për meshkujt në Shqipëri. Grupi i parë përbëhet nga meshkuj të rinj të moshës 16-23 vjeç, të cilët para se të binin në situatë shfrytëzimi jetonin në situatë rruge apo në familje me probleme madhore social-ekonomike. Grupi tjetër (më i vogël se grupi i parë) është një kategori tjetër dhe përbëhet nga meshkuj të rritur, të cilët, në kërkim të një jete më të mirë, përfundojnë në situata shfrytëzimi.

Rëndësi të madhe në këtë studim kanë intervistat e kryera në dy pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë me migrantë shqiptarë të dëbuar. Migracioni i paligjshëm është i lidhur me trafikimin. Prirjet e këtij migracioni kanë qenë vazhdimisht të larta në Shqipëri, për shkak të tranzicionit të gjatë të shoqërisë. Ndonëse asnjë prej tyre nuk

u identifikua si viktimë formale e trafikimit, shumë prej migrantëve jetonin në situata shumë të vështira pa pasur standardet minimale të jetesës dhe të punës.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e këtij vlerësimi është eksplorimi i literaturës ekzistuese mbi trafikimin e meshkujve në Shqipëri.

Hyrje

Trafikimi i personave është pranuar si një çështje me rëndësi në fushën e të drejtave të njeriut për shumë vjet. Ndonëse Shqipëria ende konsiderohet si vend origjine për burra, gra dhe fëmijë të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar, si qeveria ashtu edhe shoqëria civile kanë bërë përpjekje të qenësishme dhe kanë arritur sukses të qenësishëm në trajtimin e këtij krimi serioz dhe shkeljeje të të drejtave të njeriut. Qeveria e Shqipërisë, për shembull, ka ngritur një Mekanizëm Kombëtar Referimi (MKR) për të përmirësuar identifikimin dhe ndihmën për viktimat e trafikimit dhe ka miratuar Proçedurat Standarde të Veprimit (PSV) për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme e prezumuara të trafikimit, përfshirë viktimat meshkuj. Prej vitesh është ngritur linja e ndihmës I16006 si dhe aplikacioni “Raporto! Shpëto!”, i cili i ofron publikut një mënyrë të shpejtë dhe të lehtë për të raportuar rastet e trafikimit apo rastet e dyshuara të trafikimit.

Pavarësisht përpjekjeve, mbeten ende të patrajtuara probleme dhe çështje që lidhen me identifikimin dhe asistencën për personat e trafikuar në vend. Një shembull i dukshëm është ***mungesa e identifikimit dhe asistencës për viktimat meshkuj të trafikimit***, të trafikuar nga Shqipëria, për në Shqipëri apo brenda vendit. Perceptimi i përgjithshëm në Shqipëri për trafikimin e qenieve njerëzore është se viktimat janë kryesisht gra dhe vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual. Megjithatë, burrat dhe djemtë janë identifikuar gjithmonë e më shumë si viktima të trafikimit në vend dhe si viktima jo vetëm të trafikimit për punë por edhe për forma të tjera shfrytëzimi. Ndonëse numri i burrave dhe djemve të identifikuar deri tani është i vogël, ka arsye të besohet se çështja është më e madhe, ku disa burra dhe djem nuk janë identifikuar në mënyrë nga autoritetet, pavarësisht se tashmë ekzistojnë MKR dhe PSV.

Ky studim eksploron trafikimin e burrave dhe djemve nga vende të tjera për në Shqipëri dhe nga Shqipëria për në vende të tjera. Ai synon të hedhë dritë mbi këtë aspekt, deri më tani, të pakonsideruar sa duhet, të trafikimit të qenieve njerëzore në vend. Të kuptuarit më mirë i kësaj forme të trafikimit në vend duhet që të çojë në përmirësimin e identifikimit të burrave dhe djemve si dhe të kontribuojë në hartimin dhe dhënien e asistencës për viktimat e trafikimit.

4. Metodologjia e studimit dhe kufizime

Ky studim mbështetet në një sërë burimesh të dhënash, përfshirë të dhëna parësore dhe dytësore. Mbledhja e të dhënave është bërë në periudhën midis muajve Mars 2012 dhe Janar 2015.

Analizim i dosjeve të rasteve dhe intervistat me meshkujt e trafikuar.

Dosjet e rasteve të 23 meshkujve të trafikuar të asistuar nga D&E në periudhën midis muajve Mars 2012 dhe Janar 2015 formojnë themelin e këtij studimi. Skuadra hulumtuese i analizoi këto dosje të rasteve duke treguar vëmendje të veçantë ndaj kontekstit të prejardhjes të këtyre burrave dhe djemve, procesit të rekrutimit, përvojave të shfrytëzimit, si u larguan nga situata e trafikimit dhe nevojat për asistencë. Në vijim, u kryen tri intervista, dy me djem të trafikuar të moshës 16-18 vjeç dhe një mashkull në moshë madhore.

Intervista me ofruesit e shërbimeve që punojnë me meshkuj të trafikuar

U zhvilluan intervista me katër punonjës socialë nga OJF që punojnë në ndihmë të viktimave të trafikimit – D&E, Tjetër Vizion dhe Qendra Psiko-Sociale Vatra. Punonjësit socialë u intervistuan në lidhje me përvojat e tyre në asistencën e viktimave meshkuj të trafikimit si dhe vështirësitë dhe çështjet me të cilat janë përballur gjatë punës.

Intervista të thelluara me migrantë meshkuj të rikthyer

U zhvilluan 16 intervista me migrantë meshkuj të kthyer nga Greqia në pikat e kalimit të kufirit në Kapshticë (Korçë) dhe në Aeroportin e Rinasit. Intervistat u kryen me mbështetje nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit. Këto pika u zgjodhën për të analizuar nëse te migrantët meshkuj të kthyer kishte tregues të punës së detyruar apo të ndonjë forme tjetër shfrytëzimi. Migrantëve meshkuj iu dhanë hollësi në lidhje me studimin dhe iu paraqitën pyetjet që do t'u drejtoheshin. Fokusi i intervistave ishte përvoja e migracionit, e përqendruar më së shumti në kushtet e punës dhe vështirësitë e hasura gjatë migrimit. Në total, 16 migrantë meshkuj dhanë pëlqimin për intervistim – 10 në Aeroportin e Rinasit/ Tiranë dhe 6 në Kapshticë/ Korçë.

Intervista/pyetësorë gjysmë të strukturuar

Intervista fillestare me agjencitë që kanë përgjegjësi (ose angazhim të shfaqur) për identifikimin, referimin dhe asistencën e personave të trafikuar, migrantëve të kthyer dhe imigrantëve. Këto agjenci, identifikuan agjenci të tjera në fushën e punës dhe migracionit dhe anti-trafikimit, të cilat u kontaktuan për intervista. Gjithsej u kryen 10 intervista ballë për ballë me palët e interesuara/agjencitë, përfshirë përfaqësues nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik (1); Policia e Shtetit/ Seksioni Anti –trafik dhe seksioni i Kufirit dhe Migracionit (2); MPCSSH (1); Shërbimi Kombëtar i Punësimit (1); Inspektorati Shtetëror i Punës (1); dhe OJF (4). Intervistat u kryen në fazat fillestare të studimit me qëllim eksplorimin e përvojave të aktorëve të ndryshëm në Shqipëri në lidhje me trafikimin e meshkujve. Secilit prej të intervistuarve iu kërkua pëlqimi paraprak për intervistën, pasi i jepej informacion për qëllimin e projektit dhe studimit, temat e intervistës dhe shpjegimi se si do të përdorej informacioni i përftuar gjatë intervistës.¹

Vrojtim/pyetësor

Për të mbledhur informacion për migrimin e shqiptarëve në përgjithësi dhe për përvojat e institucioneve/agjencive me migrantët e kthyer në Shqipëri u hartua një pyetësor. Ky pyetësor kërkonte për opinione dhe rekomandime për përmirësimin e identifikimit, referimit dhe asistencës për viktimat meshkuj të trafikimit. Pyetësori iu nis me e-mail agjencive dhe institucioneve të ndryshme që merren me çështje të punës, migracionit dhe anti-trafikimit në të gjithë vendin. Pyetësori u shpërnda në mënyrë elektronike për të arritur institucione dhe agjenci që nuk e kishin të mundur të merrnin pjesë në raundin e intervistave me aktorët kryesore për shkak të kufizimeve logjistike dhe financiare. Pyetësorit iu përgjigjën pesë agjenci: dy nga Anglia, një nga Greqia dhe dy nga Shqipëria.

Rishikim literature

Ky studim mbështetet në informacione dhe të dhëna të raporteve të mëparshme, manuale dhe dokumente të tjera të mbledhura nga kërkimi në internet, nga agjenci të punës, migracionit dhe anti-trafikimit si dhe burime të tjera të rekomanduara nga aktorët përkatës në intervistat e kryera. Rishikimi i literaturës u mundua të përfshijë informacion domethënës dhe informacion të ri, si dhe të mundësojë krahasimin me vende të tjera apo aspekte dhe profile të tjera të trafikimit dhe migrimit për punë.²

¹ Duke garantuar se raporti nuk do të japë informacion identifikues për ta. Në këtë raport, kur citohet informacion nga intervistat, jepet vetem kategoria e agjencisë së cilës i përkiste i intervistuari dhe data e intervistës.

² Shih Shoja I, “Referenca”

Kufizime dhe konsiderime për metodologjinë

Ndërkohë që ky studim jep informacion të rëndësishëm dhe tërheq vëmendjen në një çështje të pashqyrtuar në Shqipëri, duhen marrë në konsideratë edhe disa kufizime. Ky studim mbështetet në një numër të vogël meshkujsh të trafikuar – 23 gjithsej. Më tej, të gjithë burrat dhe djemtë janë asistuar nga D&E përgjatë dy vjetëve të fundit. Viktimat e asistuara të trafikimit mund të jenë një nëngrupim i veçantë i viktimave të trafikimit; shumë persona të trafikuar janë të paidentifikuar dhe të pa-asistuar. Prandaj, përvoja e këtyre burrave dhe djemve nuk mund të merret si përfaqësuese e një popullate më të gjerë të meshkujve të trafikuar për në Shqipëri dhe nga Shqipëria.³ Përkundrazi, këto raste ndihmojnë për të realizuar një eksplorim fillestar të trafikimit të meshkujve nga Shqipëria dhe në Shqipëri dhe duhet në këtë kontekst.

³ Shih, për shembull, Surtees, Rebecca (2014) 'Another side of the story. Challenges in research with unidentified and unassisted trafficking victims', in Yea, Sallie (Ed.) *Human Trafficking in Asia: Forcing Issues*, Routledge; Brunovskis, Anette & Rebecca Surtees (2010) 'Untold Stories: Biases and Selection Effects in Research with Victims of Trafficking for Sexual Exploitation', *International Migration Special Issue on Human Trafficking*, 48(4), 1-37; dhe Surtees, Rebecca & Sarah Craggs (2010) *Beneath the surface. Methodological issues in research and data collection with assisted trafficking victims*, IOM dhe Instituti NEXUS.

5. Meshkujt e trafikuar: jeta dhe përvojat e trafikimit

Në periudhën midis Mars 2012 dhe Janar 2015, D&E-ja asistoi 23 meshkuj që ishin trafikuar në Shqipëri, nga Shqipëria ose brenda në Shqipëri. Ky kapitull tregon për historikun e personave dhe përvojat e trafikimit të këtyre burrave dhe djemve si dhe identifikimin dhe asistencën kanë marrë.

Historiku personal dhe karakteristikat e burrave dhe djemve të trafikuar


Pjesa më e madhe e meshkujve të identifikuar dhe të asistuar nga programi i asistencës së D&E-së ishin të mitur (d.m.th. nën 18 vjeç) në kohën kur u trafikuan. Disa ishin ende të mitur në kohën kur morën asistencë ndërsa të tjerë u identifikuan dhe morën asistencë vetëm vite më vonë (për shembull, kur ishin midis 18 dhe 21 vjeç). Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të theksuar se djemtë shqiptarë janë në rrezik trafikimi, por edhe për të treguar vonesat në marrjen e asistencës.

Të qëndruarit pa asistencë për disa vjet zgjati periudhën e shfrytëzimit dhe vuri më tej në rrezik mirëqenien e djemve. Po ashtu, mendohet të ketë kompromentuar edhe procesin e ri-integrimit të tyre; sa më vonë të merret asistenca, më i vështirë bëhet procesi i ri-integrimit.

Tabela 1.1 Moshë e meshkujve në kohën kur u trafikuan

Moshë	10-14 vjeç	15-17 vjeç	18-25 vjeç	26-42 vjeç	Gjithsej
Nr. i burrave apo djemve	6	11	3	3	23
Përqindje	26%	44%	18%	13%	100%

Grafik 1.1 Moshë e meshkujve në kohën kur u trafikuar




Të treja rastet e grupmoshës 18-25 vjeç⁴ kishin pothuajse të njëjtën histori: djem të mitur që ishin trafikuar. Ata ishin në situatë të përhershme rruge (1 rast), apo të përkohshme (1 rast), dhe një tjetër në një familje shumë jofunksionale dhe të dhunshme. Burrat, ndërkohë, ishin trafikuar nga Shqipëria dhe për në Shqipëri. Dy të huaj nga Filipinet u trafikuan për në Shqipëri për të punuar si kuzhinierë; ata ishin në moshë madhore në kohën e shfrytëzimit (27 dhe 31 vjeç). Gjithashtu, një mashkull në moshë madhore u trafikua në Afrikë për punë, në moshën 40 vjeç.

Shteti dhe vendi i origjinës

Pjesa më e madhe e burrave dhe djemve të trafikuar (21 nga 23 ose 91%) ishin nga Shqipëria. Dy meshkuj, të dy në moshë madhore, u trafikuan për në Shqipëri nga Filipinet.

Grafiku 1.2 Kombësia e meshkujve të trafikuar në Shqipëri




4 Përkatësisht - njëri 18 vjeç, një tjetër 20 vjeç dhe një 24 vjeç.

Burrat dhe djemtë shqiptarë vinin nga zona të ndryshme të vendit. Nga njëzet e një djemtë dhe burrat shqiptarë që morën ndihmë, 8 ishin nga Tirana, 6 nga Durrësi, 3 nga Kruja, 2 nga Elbasani, 1 nga Fieri dhe 1 nga Vlora.

Burrat dhe djemtë që ishin nga Tirana (8) përfshinin si ata që ishin nga Tirana me origjinë edhe ata që kishin ardhur në Tiranë në moshë të vogël, nëpërmjet migracionit të brendshëm. Në këto rastet e fundit, djemtë vinin, në mënyrë tipike, me familjet në kërkim të punës dhe mundësive, por familjet jetonin në kushte të mjerueshme dhe disa djem përfunduan pa strehë, pa pasur askënd që të kujdesej për ta. Dy djem u larguan nga familjet për shkak të neglizhimit – prindërit nuk ishin në gjendje të kujdeseshin për ta – dhe migruan në Tiranë të vetëm, duke përfunduar në rrugë.

Grafiku 1.3 Vendi i origjinës për meshkujt e trafikuar sipas numrit të rasteve



Situata dhe historiku i familjes

Nga të 20 djemtë⁵ e trafikuar, 19 vinin nga mjediset familjare që mund të përshkruhen si abuzive, neglizhuese apo të papërshtatshme për të plotësuar nevojat e tyre. Mjedisit ku ishin rritur karakterizohej nga abuzimi verbal dhe fizik.

Për shembull, një djalë, i trafikuar për punë të detyruar, përshkroi një marrëdhënie shumë të tensionuar me nënën, e cila shpesh e neglizhonte. Ndjenjat e saj ndaj tij u ilustruan me një shembull të përgjigjes së saj kur ai kërcënoi se do të hidhej nga shkallët, sepse ajo nuk po i tregonte mjaft vëmendje. Ajo u përgjigj thjesht: “Hidhu nëse do”.

Në disa raste, prindërit ishin divorcuar apo një prind kishte vdekur dhe prindi tjetër nuk ishte në gjendje të kujdesej si duhej për shkak të faktorëve ekonomikë.

5 Në këtë dokument, termi djalë është përdorur për grupmoshën 18-25 vjeç.

Disa djem ishin braktisur nga njëri apo nga të dy prindërit. Një djalë i shfrytëzuar për kriminalitet të detyruar kishte një përvojë veçanërisht të dhimbshme. Në moshën nëntë vjeçe prindërit ishin ndarë dhe nëna e braktisi familjen. Ai e ndoqi nënën në një qytet tjetër me shpresën se do të jetonte me të. Kur arriti në shtëpinë ku jetonte e ëma, “njerku” nuk e lejoi të hynte brenda. E lanë jashtë në moshën nëntë vjeçare, të mbijetonte në rrugë, në temperatura të acarta dimri, duke fjetur i mbuluar vetëm me një copë plastmase.

Marrëdhëniet me familjet shpesh kanë qenë të paqëndrueshme dhe të karakterizuara nga konflikti i vazhdueshëm. Në disa raste, personat përgjegjës për kujdesin e djemve (p.sh. prindërit apo njerku/a) kanë shfaqur sjellje problematike të tilla si varësia nga alkooli, kumari, tradhëtia bashkëshortore etj.).

Disa djem, të detyruar nga abuzimi dhe neglizhimi ekstrem, ishin larguar nga shtëpia dhe përfunduan të jetojnë në rrugë. Në këtë situatë ishin 14 nga djemtë e asistuar. Disa ishin rreth nëntë vjeç kur përfunduan pa strehë; të tjerë ishin adoleshentë të rritur (16-17 vjeç). Në 10 raste, situata e të qenit pa strehë çoi pothuaj drejtpërdrejt në trafikim të tyre. Kështu, ndërsa djemtë jetonin në situatë rruge, ata shënjestroheshin nga të rritur që shfrytëzonin situatën e tyre të dobët, duke i joshur dhe duke i futur në kriminalitet të detyruar apo shfrytëzim seksual. Disave u ofrohej strehë, të tjerëve ushqim dhe një shumë e vogël parash si mjete për të fituar pëlqimin e tyre.

Në dy raste, baballarët e djemve i kishin shfrytëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë fëmijët për punë. Një djalë ishte detyruar të punojë e të shesë peshk, ndërsa tjetri u detyrua të punojë si kamerier. Në të dy rastet, baballarët i kërcënonin djemtë me abuzim fizik dhe i detyronin të linin shkollën për të punuar.

Njëri prej tyre kishte qenë në institucion që kur kishte lindur, ndërsa katër të tjerët ishin vendosur në institucione si rezultati i abuzimit në familje (një djalë), të vdekjes së një prindi (dy djem) apo si rezultati i pamundësisë së prindit të vetëm për kujdes (një djalë). Në një rast, procesi i trafikimit filloi kur rasti ishte në institucion. Ndërsa në rastet e tjera, procesi i trafikimit filloi pas daljes nga institucioni, zakonisht duke rënë në situatë rruge. Në këto raste, situata ndikohet nga mungesa e praktikave të qarta për mbrojtjen e fëmijëve. Ndonëse nuk përmbusheshin kushtet për nxjerrjen nga institucioni, ata u kthyen në familjet e tyre të copëtuara dhe më vonë përfunduan përsëri në situatë rruge.

Situata e familjes së burrave në moshë madhore të shfrytëzuar për punë të detyruar ishte shumë ndryshe krahasuar me djemtë e trafikuar. Dy prej burrave (një shqiptar dhe një filipinas) vinin nga martesat të qëndrueshme dhe kishin fëmijë, me të cilët kishin

marrëdhënie të forta. Prej këtyre marrëdhënieve dhe dëshirës për të mbështetur më mirë familjet, ata migruan për punë, gjë që i çoi më pas në një situatë trafikimi. Njëri prej tyre përshkroi trishtimin e madh që ndjeu kur nuk ishte në gjendje të merrte në krahë vajzën pas kthimit në shtëpi, për shkak të dëmtimeve që kishte marrë gjatë trafikimit. Ai ishte sulmuar dhunshëm nga truprojat e punëdhënësit dhe kishte pësuar dëmtime të tendinave të krahut dhe nuk ishte në gjendje të mbante pesha të rënda. Kjo e pengon të punojë përsëri në profesionin e tij. Dhe ishte dëshira për t'u kthyer menjëherë pranë familjes që e shtyu një nga viktimat e huaja të trafikimit të kthehej në shtëpi.

Burri tjetër nga Filipinet që u shfrytëzua në Shqipëri dhe Kosovë kishte disa mosmarrëveshje me të afërmit meqë planifikonte të migronte në Kosovë. Ai ndjehej pak në ankth dhe dyshim nëse do të kthehej përsëri në Filipine, sidomos pas përvojës së vështirë dhe faktit se nuk kishte fituar asnjë gjë pas rreth gjashtë muajve që kishte qëndruar në Shqipëri dhe Kosovë.

Gjendja ekonomike

Djemtë e trafikuar vinin nga familje tejet të varfra, në disa raste në varfëri ekstreme dhe të pastreha. Shpesh, djemtë jetonin në shtëpi nën standard para se të trafikoheshin dhe një numër i konsiderueshëm i djemve (njëmbëdhjetë djem) ishin praktikisht pa strehë dhe jetonin në rrugë në kohën e trafikimit. Në përgjithësi, familjet e djemve ishin të varfra dhe pa mjetet e mjaftueshme për të mbështetur si duhet fëmijët, duke bërë që disa prindër t'i nxisnin fëmijët të linin shkollën dhe të punonin. Në disa raste, kjo çoi në trafikimin e tyre.

Përkundrazi, gjendja ekonomike e tre meshkujve në moshë madhore të shfrytëzuar për punë të detyruar ishte ndryshe. Burrat kishin gjendje ekonomike mesatare dhe profesion të qëndrueshëm. Meshkujt filipinas të shfrytëzuar për punë të detyruar ishin shefa kuzhine profesionistë dhe migruan në Kosovë dhe Shqipëri me shpresën se do të gjenin kushte më të mira pune dhe paga më të larta se sa në vendin e tyre të origjinës. Po ashtu, burri shqiptar i trafikuar për punë të detyruar në Afrikë ishte punëtor ndërtimi i kualifikuar dhe me përvojë. Ai ishte në marrëdhënie pune në kohën e rekrutimit, por e pranoi këtë punë për shkak të pagës së lartë të premtuar nga punëdhënësi (vetëm premtuar, nuk iu dha plotësisht).

Arsimimi


Niveli i arsimimit të burrave dhe djemve të trafikuar kishte ndryshime të qenësishme.

Pjesa më e madhe e djemve të trafikuar e kishin braktisur shkollën më moshë fare të vogël dhe kishin arsimim shumë të kufizuar. Shpesh, e kishin braktisur shkollën sepse ishin detyruar të lypnin në rrugë, për të ndihmuar e mbështetur familjen ose sepse thjesht ishin detyruar për të lypur. Nëntë nga 20 djemtë kishin braktisur shkollën fillore, që do të thotë se kishin përfunduar vetëm pak vite shkollë. Kjo do të thotë se shumë prej tyre ishin ose analfabetë ose kishin njohuri bazë të leximit dhe veprimeve me numrat.

Dy nga njëzetë djemtë e braktisën shkollën në klasën e gjashtë dhe të tetë dhe katër djem në vite më të larta, duke përfunduar nëntë vjet (tre djem) dhe dhjetë vjet (një prej tyre). Në vijim të sa më lart, dy djem kanë përfunduar shkollën e mesme dhe dy të tjerë vazhdojnë shkollën, aktualisht në klasën e nëntë. Më tej, një djalë (i ri) është regjistruar aktualisht për të studiuar në universitet.

Niveli i arsimimit të meshkujve të rritur ishte përgjithësisht më i lartë, ku të tre kishin përfunduar shkollën e mesme dhe kishin ndjekur trajnime profesionale si shefa në dy raste dhe punëtor ndërtimi në një rast.

Grafiku 1.4 Niveli i arsimimit të meshkujve (burra dhe djem) të trafikuar, në për qind



Djemtë e trafikuar kanë nivel shumë më të ulët arsimimi se sa niveli tipik në Shqipëri. Numri mesatar i viteve të shkollimit në Shqipëri është 11.9 vjet.⁶ Përkundrazi, numri

⁶ Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar. – Ministria e Arsimit dhe Shkencës, korrik 2009

mesatar i viteve të shkollimit të djemve të trafikuar është vetëm 5.5 vjet, duke i vendosur në disavantazh të dukshëm si punëkërkuar apo për ngritjen e një biznesi të vogël, që kërkon nivele të mjaftueshme të aftësive të leximit dhe shkrimit dhe të veprimeve me numrat. Për shembull, dy djem e patën të vështirë të shkruanin madje edhe emrin e tyre; gjashtë djem nuk ishin në gjendje të lexonin dhe shkruanin rrjedhshëm në shqip dhe kishin vështirësi në veprime të thjeshta shumëzimi apo pjesëtimi.

Ndërsa lënia e shkollës mund të rrisë rrezikun për trafikim, në shumë raste lënia apo ndërprerja e arsimimit është pasojë e një situatë ekzistuese në të cilën ndodhet individi – varfëri ekstreme, mungesë stabiliteti në familje, përfshirje e hershme në punën e të miturve, etj. Për shembull, pjesa më e madhe e fëmijëve të përfshirë në situatë rruge e braktisin herët ose nuk janë në gjendje ta ndjekin shkollën. Sipas një studimi për fëmijët e përfshirë në situatë rruge nga UNICEF, ARSISS, SHKEJ, dhe FBSH⁷, rreth 41% e fëmijëve të intervistuar që u gjenden në situatë rruge e kishin braktisur shkollën, ndërsa 21% prej tyre nuk kishin qenë në shkollë dhe vetëm 38% vazhdonin të ndiqnin shkollën.

Në ndryshim nga djemtë, meshkujt e rritur kishin mesatarisht 11.6 vjet arsimim, në përputhje me mesataren kombëtare. Gjithashtu, secili prej tyre kishte përfunduar trajnim profesional si pjesë të arsimimit të tyre dhe kishin profesion.

Tabela 1.2. Numri mesatar i viteve të shkollimit për meshkujt e trafikuar

Kategoria e meshkujve të trafikuar	Numri mesatar i viteve të shkollimit
Djem	5.5 vjet
Burra	11.6 vjet

Prejardhja etnike

Nga 21 djemtë dhe burrat shqiptarë, 12 ishin shqiptarë etnikë dhe nëntë ishin romë dhe egjiptianë.⁸ Kjo përbërje ka ndryshuar me kalimin e kohës, ku shumica e viktimave meshkuj të trafikimit që u identifikuan në fillim

⁷ Studim kombëtar për fëmijët në situatë rruge – ARSIS, GFK

⁸ Census 2011 - INSTAT <http://www.instat.gov.al/census/census-2011/t%C3%AB-dh%C3%ABnat-e-census-2011.aspx> Pjesa më e madhe (82.5%) e njerëzve në Shqipëri identifikohen si shqiptarë etnikë. Shqipëria njihet pakica kombëtare (greke, maqedonase dhe malazeze) dhe dy pakica kulturore (arumunët dhe romët). Egjiptasit e ballkanit përbëjnë gjithashtu një pakicë etnike në vend. Censusi më i fundit (2011) për të përfshirë informacion mbi grupet etnike dhe kombësinë, e qartësoi popullsinë e Shqipërisë sipas grupit etnik si më poshtë: grekë .87%; maqedonas .2%; malazezë .01%; egjiptianë të Ballkanit .12%; romë .3%; dhe arumunë.3%. Në censusin e 2011, 14% e popullsisë nuk e deklaroi kombësinë.

vinin nga komuniteti rom dhe egjiptian, për shkak se pjesa më e madhe e fëmijëve në situatë rruge i përkasin këtij komuniteti. Megjithatë, së fundi, një numër në rritje i meshkujve etnikë shqiptarë janë identifikuar si të trafikuar. Ndryshimi mund të ketë ardhur nga rritja e numrit të agjencive dhe OJF-ve që marrin pjesë në procesin e referimit dhe që kanë një mbulim më të plotë të identifikimit të grupeve të ndryshme. Si rrjedhojë, procesi i identifikimit po shkon drejt një qasjeje më tërësore dhe “disi më të zgjuar”. Identifikimi po shkon përtej rasteve më të dukshme të trafikimit (p.sh. fëmijët romë të përfshirë në situatë rruge) për të përfshirë situata më pak të dukshme trafikimi (p.sh. djem të rinj, përfshirë shqiptarë etnikë). Dy prej burrave ishin nga Filipinet; etniciteti i tyre specifik nuk ishte i dokumentuar dhe nuk dihet.

Tabela 1.3. Përbërja etnike e viktimave shqiptare të trafikimit

Etniciteti i VeT shqiptare	Numri i viktimave
Romë/Egjiptianë	9
Shumicë shqiptare	12
Etnia VeT të huaj	Numri i viktimave
Filipinas (etniciteti nuk dihet)	2

Rekrutimi

Rekrutimi ka ndodhur në mënyra të ndryshme, në varësi të formës së trafikimit.

Disa djem të rinj ishin përfshirë në lypje, veprimtari kriminale dhe shfrytëzim seksual, të detyruar nga abuzimi dhe neglizhimi ekstrem nga ana e familjarëve, janë larguar nga shtëpia në moshë shumë të vogël dhe e kanë gjetur veten të pastrehë që kur kanë qenë disa prej tyre 9-12 vjeç, dhe të tjerë 16-17 vjeç. Disa u përfshinë në lypje dhe punë të detyruar që herët (duke mbledhur hekurishte dhe materiale të ndryshme të riciklueshme) që në fëmijëri të hershme, si nevojë për të gjetur strehë diku. Kjo situatë u përdor nga persona të tretë, që në këmbim të strehimit apo përfitime ekonomike (sa për të blerë ca ushqim) i shfrytëzonin për veprimtari kriminale si shpërndarje droge, lypje apo edhe qëllime seksuale. Në disa raste, lypja është formë shfrytëzimi që ka filluar në familje. Në ato raste që janë përfshirë në lypje, kanë filluar si fillim të shtyrë apo të detyruar nga familjarët. Duke e gjetur veten në situatë rruge për pjesën më të madhe të ditës, njëri nga djemtë ra në kontakt me njerëz që e çuan në të gjithë Shqipërinë për të lypur. Në situata të tjera, shfrytëzimi për lypje organizohej drejtpërdrejt nga familja.

“M. është një mashkull tridhjetëvjeçar me vonesë të moderuar zhvillimi. Atë e çoi në Kosovë i vëllai, që e detyroi M. të lypte në rrugët e Prishtinës. M. u gjet nga policia e Prishtinës dhe i vëllai u arrestua për trafikim dhe M. u dërgua në kufirin me Shqipërinë nga policia e Kosovës.”

Gjithashtu, disa të mitur u përdorën për të shpërndarë drogë apo për të vjedhur. Pasi e gjetën veten në situatë rruge, u rekrutuan nga të rriturit në moshën 12-13 vjeçare. Një prej djemve, **thotë se e mbushte çantën e shkollës me narkotikë kur ishte vetëm 11 vjeç dhe e transportonte në zona të ndryshme të Tiranës, i mbikëqyrur nga rekrutuesit.** Në disa raste, rënia në shfrytëzim është pasojë e drejtpërdrejtë e një familjeje të rrënuar. Mosgjetja e mbështetjes në familje, i ka shtyrë disa të mitur në marrëdhënie me njerëz të rrezikshëm që shfrytëzuan pozicionin e tyre të dobët.

Siç u vu në dukje më herët, në të paktën dy raste, pjesëtarë të familjes ishin përgjegjës drejtpërdrejt për rekrutimin dhe shfrytëzimin e viktimave meshkuj të trafikimit. Dy djem të intervistuar për qëllime të studimit ishin shfrytëzuar pa punë nga baballarët. Këta burra i kishin detyruar djemtë të linin shkollën për të punuar dhe ua merrnin fitimet.

“L. është 19 vjeç. Ai u rrit në një familje jofunksionale, ku nëna dhe babai kishin sherre të vazhdueshme mes tyre. Herë ndaheshin e herë bashkoheshin, e kjo ndodhte shpesh. Pas ca kohësh, nëna e braktisi përfundimisht familjen. L. u përpoq ta ndiqte të ëmën në një qytet tjetër në Shqipëri ku jetonte me të dashurin, po ky nuk e lejoi L. të jetonte bashkë me ta. Ndaj, L. përfundoi në situatë rruge, duke u përballur me acarim e dimrit të këtij qyteti kur ishte vetëm 9-vjeç. Ai qëndroi për një kohë të gjatë në situatë rruge. Kjo situatë e vështirë e L. u shfrytëzua nga të tjerë, që e shtynë L. të shpërndante drogë kur ishte vetëm 12-13 vjeç.”

Rekrutimi i meshkujve në moshë madhore të shfrytëzuar për punë kryhet në mënyrë më formale. Secili prej burrave kishte kërkuar të emigronte në një vend tjetër për punë dhe ishin duke i kërkuar në mënyrë aktive këto mundësi. Për shembull, dy burrat filipinas po kërkonin punë dhe kontaktuan një vajzë filipinase që punonte në Kosovë. Vajza u dha adresën e punëdhënësit të saj dhe ata e kontaktuan këtë person në Kosovë nëpërmjet e-mailit me shpresën se do të punësoheshin si kuzhinierë profesionistë për 1000 euro rrogë. Por, ajo që iu premtua dhe pritshmëritë e tyre nuk u realizuan. Përkundrazi, u paguan më pak, nuk e merrnin rrogën rregullisht, punonin më shumë se ishte rënë dakord, pasaportat iu morën dhe nuk mund të lëviznin lirisht.

E njëjta situatë paraqitet në rastin e një burri shqiptar i trafikuar për punë të detyruar në Afrikë. Një kompani ndërtimi kishte kontaktuar persona të ndryshëm që punonin në fushën e ndërtimit dhe ata gjeten miq dhe kolegë për të punuar së bashku në një vend jashtë. Së pari, u thanë se do të punonin në Dubai dhe më pas përfunduan në Kongo. Iu premtuan kushte të mira pune dhe iu treguan fotografi të vendit ku do të qëndronin. Të gjithë punëtorët ishin në kërkim të një page më të mirë apo mundësive më të mira për punë krahasuar me atë që fitonin në Shqipëri. Por, përfunduan në kushte pune ekstremisht të këqija, iu morën pasaportat dhe iu kërkua të punonin edhe natën dhe, kur kundërshtonin urdhrat, i rrihnin.

Vendet e shfrytëzimit

Pjesa më e madhe e burrave dhe djemve (21) u shfrytëzuan brenda Shqipërisë. Këtu përfshihen 19 djem dhe burra të trafikuar brenda vendit për forma të ndryshme shfrytëzimi – shfrytëzim seksual (5), lypje (2), veprimtari kriminale (4), punë e detyruar (2), forma të shumëfishta trafikimi (6).

Në dy rastet e tjera, burrat u trafikuan nga Filipinet, së pari në Kosovë dhe më pas në Shqipëri ku u detyruan të punonin si kuzhinierë.

Dy meshkuj shqiptarë u trafikuan jashtë vendit – njëri në Kosovë për lypje të detyruar dhe tjetri në Afrikë për punë në ndërtim. Një burrë (30 vjeç aktualisht, po trafikimi kishte ndodhur më herët) u shfrytëzua në Kosovë për lypje të detyruar. Ai ka një aftësi të kufizuar zhvillimore në shkallë të moderuar dhe u detyrua nga i vëllai të lypë në rrugët e Prishtinës.

Është interesant fakti se të gjithë meshkujt madhorë të identifikuar që vuajtën nga puna e detyruar u shfrytëzuan jashtë vendit përkatës. Kjo mund të lidhet me faktin se ishin në kërkim të mundësive të mira dhe të mirë-paguara punësimi, dhe zakonisht përpiqen t'i gjejnë nëpërmjet migracionit edhe në vende të tjera për shkak të pagave më të larta dhe pritshmërive më të larta për më shumë mundësi për një punë më të mirë.

Tabela 1.4 Vendet ku u shfrytëzuan

Vendi	Shqipëri	Kosovë & Shqipëri	Kosovë	Afrikë
Nr. i burrave dhe djemve të shfrytëzuar	19	1	2	1


Lloji i trafikimit, forma e shfrytëzimit

Burrat dhe djemtë e trafikuar u shfrytëzuan në forma të ndryshme. Ndërsa presupozohet zakonisht se meshkujt shfrytëzohen kryesisht për punë, përvoja e këtyre burrave dhe djemve zbulon një larmi më të madhe të përvojave të trafikimit. Me fjalë të tjera, përveç pesë rasteve të trafikimit për punë, burrat dhe djemtë u trafikuan edhe për shfrytëzim seksual (5), veprimtari kriminale (4) dhe lypje (3). Për t'u vënë në dukje është se më shumë se një e katërta e meshkujve të trafikuar (6) vuajtën më shumë se një lloj shfrytëzimi. Në tri raste (13%), djemtë u shfrytëzuan për qëllime seksuale si dhe për lypje; dy (9%) u shfrytëzuan për lypje dhe veprimtari kriminale në të njëjtën kohë, dhe një (4%) për qëllime seksuale dhe veprimtari kriminale (shpërndarje droge). Tabela 1.5 paraqet më me hollësi format e ndryshme të shfrytëzimit.

Tabela 1.5. Format e shfrytëzimit

Format e shfrytëzimit	Nr. i personave	Përqindja
Veprimtari kriminale dhe lypje	2	9%
Shfrytëzim seksual dhe veprimtari kriminale	1	4%
Shfrytëzim seksual dhe lypje	3	13%
Shfrytëzim për punë	5	22%
Shfrytëzim seksual	5	22%
Veprimtari kriminale	4	17%
Lypje	3	13%
Gjithsej	23	100%

Grafiku 1.5 Format e shfrytëzimit



Deri diku, ekziston një korrelacion midis moshës së burrave apo djemve të trafikuar dhe formës së shfrytëzimit. Për shembull, tre burrat e trafikuar për punë ishin meshkuj në moshë madhore, që u nisën të migronin për punë por u trafikuan. Përkundrazi, ata të trafikuar për lypje, veprimtari kriminale dhe shfrytëzim seksual ishin kryesisht djem të ekspozuar ndaj shfrytëzimit si rrjedhojë e situatës së tyre vulnerabël përfshirë 9 raste të jetës në situatë rruge.

Të trafikuar për punë

Gjithsej, pesë burra dhe djem u trafikuan për forma të ndryshme të punës së detyruar.

Dy djem u trafikuan njëri për të shitur peshk dhe tjetri për të punuar si kamerier. Ata u detyruan të punojnë nga baballarët e tyre, që i dhunuan dhe u morën gjithë sa fitonin.

Dy burra u trafikuan nga Filipinet në Kosovë dhe më pas në Shqipëri si kuzhinierë. Rasti studimor më poshtë ilustron përvojën e tyre.

Rast studimor #2. Punë e detyruar për burrat në Shqipëri

D. është shef kuzhine nga Filipinet. Me ndërmjetësimin e një filipinase që punonte në Kosovë, ai kontaktoi me një punëdhënës në Kosovë me shpresën se do të gjente një punë të përshtatshme aty. Tre vjet më parë, shkoi në Kosovë për herë të parë me avion, pas marrëveshjes që kishin bërë me punëdhënësin. Ai kishte një mik nga Filipinet që punonte në Kosovë. Kur arriti në Kosovë, u takua me personin që i kishte dërguar ftesën. Pas disa ditësh, D. filloi të punonte në një restorant në Kosovë, por asnjëherë nuk mori pagën që i ishte premtuar, përkundrazi mori pothuajse sa gjysma e premtuar. Punëdhënësi i mori pasaportën dhe asnjëherë nuk ia ktheu sa ishte në Kosovë. Dishte shumë i kufizuar në lëvizje dhe gjithmonë e mbanin nën kontroll. Së bashku me mikun e tij, udhëtuan për në Shqipëri dhe gjithmonë ishin të shoqëruar nga njerëzit e punëdhënësit. I fshihën në fund të autobusit dhe policia kufitare nuk i pikasi ndërsa e kaluan kufirin.

Së bashku me një grup shqiptarësh, një burrë u trafikua në Afrikë ku u shfrytëzua për punë të detyruar. Ata u kontraktuan për të punuar në ndërtim në disa prej hoteleve që po ndërtoheshin në po atë vend. Aty u infektuan nga malaria dhe jetonin e punonin në kushte çnjerëzore në disa baraka. Sipas tij *'biznesi që u premtoi punën, nuk u tregoi*

saktësisht vendin e punës, i mashtrroi për pagën dhe kushtet e punës'. Në fillim, përfaqësuesi i kompanisë u tha se do të punonin në Katar, po më vonë e ndryshoi destinacionin disa herë. Megjithatë paga e premtuar ishte 100 000 lek në muaj, në kontratë thuhej vetëm 25 000 lek në muaj. Ata e nënshkruan kontratën me idenë se kishin edhe një biletë vajtje-ardhje. Kur ishin ende në Shqipëri, përfaqësuesi i kompanisë u tregoi foto të vendit ku do të qëndronin. Në fotografi kushtet ishin shumë të mira, por, kur arritën në Afrikë, ata vunë re se asgjë nuk ishte si në fotografitë që kishin parë. Në fakt, ata jetonin në kushte shumë të këqija dhe të dëmshme. Sapo mbërritën, punëdhënësi u mori pasaportat me justifikimin se u duheshin për të marrë vizat. Kur i kërkonin pasaportat nuk i merrnin dhe, në disa raste, u abuzuan nga truporët e punëdhënësit. Nuk kishin akses në kujdes shëndetësor. Personi thotë "...shikonim çdo ditë punonjës që rrezoheshin se ishin sëmurë, por asnjë nuk e çante kokën, dhe për asnjë prej tyre nuk u thirr ambulanca ... Kuptova se isha sëmurë sepse më kishte rënë imuniteti dhe temperatura ishte 41°C. Askush nuk donte t'ia dinte për këtë. Isha në dorë të Zotit".

Vlen të theksohet se ky burrë u trafikua bashkë me meshkuj të tjerë shqiptarë, çka sugjeron se shfrytëzimi i meshkujve në moshë madhore për punë është shumë më i madh sesa tregohet nga identifikimi dhe numri i viktimave të asistuar.

Gjasat për një shkallë më të madhe shfrytëzimi të meshkujve në moshë madhore për punë sinjalizohen edhe nga intervistat me migrantët shqiptarë të kthyer apo të dëbuar në 2012. Tre migrantë të kthyer, për shembull, i përshkruanin kushtet e punës dhe të jetës në Greqi si shfrytëzuese, informacioni i dhënë sugjeron se disa nga këto raste mund të kenë qenë gjithashtu raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Një migrant i kthyer e shpjegon kështu situatën e tij:

Na paguanin 500 euro në muaj si bari. Kjo është pagesë shumë e ulët krahasuar me standardin e Greqisë. Punoja tërë ditën deri në mbrëmje, shtatë ditë të javës. Puna fillonte në orën 7 në mëngjes dhe mbaronte në orën 8 të mbrëmjes. Flija në një shtëpizë të vogël, të cilën pronari e kishte ndërtuar enkas për ne. Nuk kisha asnjë lloj siguracioni pasi isha atje pa letra.

Një tjetër i intervistuar informoi se kishte punuar si druvar në malet e Greqisë. Kushtet e punës ishin shumë të këqija, jetonte në një barakë me disa të tjerë. Punëdhënësi nuk i trajtonte keq, po ishte vetë natyra e punës me rrezik. Punonte shtatë ditët e javës me 30 euro dita. Askush nuk e çonte nëpër mend kontratën dhe siguracionet – tha ai – pasi ishim të gjithë pa letra.

Një i tretë, që kishte punuar gjithashtu si druvar, informoi se kishte punuar për gjashtë muaj në këtë punë dhe kohët e fundit kishte pasur probleme me punëdhënësin - "pronarin" - sepse nuk e kishte paguar dhe i detyrohej 1700 euro për tre muajt e fundit. Punëdhënësi i kishte thënë se do ta paguante kur të shitej produkti dhe për këtë arsye do ta paguajë. Ai qëndroi dhe nuk u largua të kërkonte ndonjë punë tjetër.

Lypja e detyruar

Gjithsej u trafikuan tre djem për lypje të detyruar. Zakonisht, dhe fatkeqësisht, procesi i shfrytëzimit ka filluar që kur ishin fëmijë në familjet e tyre. Ata janë fëmijë të prindërve që kishin lypur edhe vetë kur ishin fëmijë. Procesi i nisur nga prindërit vazhdon nga njerëz të tjerë, që përfitojnë nga situata vulnerabël e të miturve, si për shembull në rastin e përshkruar më poshtë.

Rast studimor #3

A. është 19 vjeç. Ai u lind në një familje ku babai ishte i dhunshëm si ndaj tij edhe ndaj të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes. A. u detyruar nga i ati të lypje që në moshë të vogël. Të gjitha paratë që fitonte i merreshin me forcë nga babai, që i përdorte për të luajtur kumar apo për të pirë alkool. Ai kujton se njëherë, pasi kishte lypur gjithë ditën, po pushonte dhe po hante diçka për drekë. I ati erdhi papritur dhe e qëlloi, se po hante drekë në vend që të dilte të lypje. Ai ka lypur në qytete të ndryshme të Shqipërisë që kur ishte 11 vjeç. Megjithatë, nuk dëshironte të tregonte se kush e kishte transportuar në këto vende dhe kujt ia jepte paratë e fituara nga lypja.

Në disa raste, djemtë e detyruar të lypin në rrugë janë shitur edhe për prostitucion. Ata janë shfrytëzuar për marrëdhënie seksuale me të rritur. Sipas informacionit nga dosjet e rasteve, zakonisht keqbërësit ishin pedofilë të moshës 30-50 vjeç. Te tjerë djem janë shfrytëzuar njëkohësisht për forma të tjera trafikimi si dhe për lypje. Tre djem u shfrytëzuan për qëllime seksuale si dhe për lypje kur ishin të mitur. Për shkak se ishin larguar nga shtëpia, të qëndrimit për një kohë të gjatë në situatë rruge dhe paaftësisë së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri për të gjetur zgjidhje të përshtatshme dhe të qëndrueshme për ta, ata ishin në kontakt me persona të ndryshëm në moshë madhore që i shfrytëzuan për qëllime seksuale, duke u ofruar ushqim dhe strehë në këmbim të ca parave.

Një prej djemve u shfrytëzua për lypje dhe aktivitet kriminal. Përveç lypjes në rrugë, ai u detyrua të punonte si korrier droge, për të transportuar drogë nga një pikë e qytetit në tjetrën. Kur u pyet për shfrytëzuesit, ai nuk dëshironte të fliste për ta.

Shfrytëzimi seksual

Pesë djem të mitur u shfrytëzuan për qëllime seksuale ndërsa katër të tjerë përjetuan shfrytëzim seksual dhe forma të tjera shfrytëzimi si për shembull kriminalitet i detyruar (1) dhe lypje (3).

Shfrytëzimi seksual zakonisht ka filluar rreth moshës 13 - 14 vjeç. Ka pasur disa raste të shfrytëzuar nga pedofilët që më pas gjejnë klientë të tjerë dhe pjesa më e madhe e pagesës merrej prej tyre. Në disa raste ka pasur grupe të mirë-organizuar që i transportonin të miturit në qytete të ndryshme bregdetare të Shqipërisë, dhe vepronin me klientë turistë që përdornin hotelet dhe motelet në zonat nën-urbane të qyteteve.

Në disa raste, shfrytëzimi seksual ishte pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit në situatë rruge, ku askush nuk kujdesej dhe nuk ishte në gjendje të plotësonte madje edhe nevojat më bazike. Shfrytëzuesit e tyre përdorin përmbushjen e këtyre nevojave bazë si ushqim apo strehë për të përfituar prej tyre. Shpesh kjo është një përvojë e errët për djemtë, diçka për të cilën ndihen me turp dhe që nuk i duhet treguar kurrë askujt, madje as menaxherit të rastit.

Gjithashtu, disa prej djemve janë shfrytëzuar edhe për forma të tjera përveç shfrytëzimit seksual. Këtu përfshihen tre fëmijë që janë shfrytëzuar edhe për lypje dhe një djalë që iu kërkua të shpërndante drogë ndërkohë që ishin edhe të shfrytëzuar seksualisht.

Rast studimor #4

E. është 15 vjeç. Ai jeton me familjen po marrëdhënia me ta nuk është aspak e mirë. E. u rrit në një institucion përkujdesës që kur ishte fëmijë. Kur ishte 14 vjeç u rikthye në familje, po për shkak të marrëdhënies së vështirë me babanë, u largua nga shtëpia dhe përfundoi në situatë rruge. Këtu ai ra në kontakt me një të rritur që e përdori pozitën vulnerabël të djalit për ta shfrytëzuar seksualisht apo edhe për ta përdorur për shpërndarje droge në dy qytete. E dërguan në një qytet bregdetar në Shqipëri dhe u shfrytëzua seksualisht së bashku me të mitur të tjerë të moshës 14-18 vjeç në një motel në periferi të qytetit.

Veprimtari kriminale

Katër meshkuj u shfrytëzuan për veprimtari kriminale përfshirë shpërndarjen e drogës (2 raste), kultivimin e kanabis-it (1 rast) dhe vjedhje (1 rast). Në të gjitha këto raste janë shfrytëzuar situatat e vështira të të miturve për t'i detyruar të shpërndajnë drogë apo të vjedhin. Dy prej djemve që u shfrytëzuan për shpërndarje droge ishin në situatë rruge dhe u rekrutuan nga banda që përdorën moshën (13 dhe 14 vjeç) dhe situatën e djemve për t'i shfrytëzuar. Djali që u shfrytëzua për vjedhje vinte nga një familje e shkatërruar.

'H. ishte 14 vjeç, rritur në një familje abuzive. Që herët u përfshi në krime të vogla si vjedhje, i shtyrë nga të rritur që shfrytëzonin situatën e tij të vështirë. Pjesa më e madhe e fitimeve merrej nga të rriturit që e kontrollonin duke e mashtruar dhe duke i thënë se u duhej të shlyenin disa borxhe e u duheshin ca para'.

6. Identifikimi i meshkujve të trafikuar në Shqipëri – modele dhe barriera

Modele të identifikimit ndër meshkujt shqiptarë të trafikuar

Identifikimi i meshkujve të trafikuar në Shqipëri është aktualisht shumë i kufizuar. Pjesa më e madhe e viktimave të identifikuara të trafikimit janë gra dhe vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual. Thënë këtë, identifikimi i meshkujve të trafikuar është në rritje në krahasim me vitet e mëparshme. Raporti i SHBA-ve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore nuk ka raportuar asnjë rast të meshkujve të trafikuar ndër viktimat e identifikuara të trafikimit para vitit 2012. Megjithatë, në vitin 2012, 11 nga 92 viktima të trafikimit (ose 12% të rasteve të identifikuara) ishin meshkuj.⁹ Më tej, në vitin 2013, 15 nga 95 viktimat e identifikuara të trafikimit të vërejtura në Raportin e SHBA-ve ishin meshkuj – ose 14%. Po ashtu, midis vitit 2012 dhe 2015, D&E-ja asistoi 23 meshkuj të trafikuar të identifikuar në Shqipëri përfshirë dy meshkuj të huaj viktima të trafikimit.

Gjithashtu, në të shkuarën, meshkujt identifikoheshin në fillim vetëm si viktima të shfrytëzimit për punë dhe lypje të detyruar (jo si viktima të shfrytëzimit seksual). Për shembull, nga viti 2000 në vitin 2004, në Shqipëri u identifikuan 156 raste të trafikimit për punë, lypje dhe vepra kriminale, shumica djem (midis 69.2% dhe 79.3% çdo vit).¹⁰ Asnjë rast shfrytëzimi seksual i djemve nuk u dokumentua dhe as nuk ishte praktikë e zakonshme të dokumentohej abuzimi seksual i djemve ndër fëmijët e trafikuar në rrugë, pavarësisht nga mbivendosja domethënëse midis llojeve të ndryshme të shfrytëzimit. Megjithatë, midis 2012 dhe 2015, D&E-ja ka identifikuar dhe asistuar 5 djem që ishin trafikuar për shfrytëzim seksual dhe 4 djem që kishin vuajtur shfrytëzim seksual së bashku me trajta të tjera të abuzimit.

Në identifikim përfshihen një sërë agjencish dhe institucionesh. Pjesa më e madhe e djemve të trafikuar u identifikuan dhe referuan nga OJF dhe organizata ndërkombëtare.

Rastet e para të djemve të rinj VeT u identifikuan dhe referuan nga organizata që punojnë për të asistuar fëmijët dhe të rinjtë në nevojë. Sipas analizave të të dhënave

⁹ Raporti Vjetor i Departamentit të Shtetit të SHBA për Trafikimin e Personave – Shqipëria 2013.

¹⁰ Surtees, R. (2005) *Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe*, Regional Clearing Point, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, f. 78.

të rasteve, proçesi i shfrytëzimit për këta persona fillonte që në vite të hershme, por ata nuk identifikoheshin si raste të trafikimit në persona deri së fundmi kur u referuan për ndihmë në D&E. Ata ishin në situatë të vështirë e të pambrojtur kur hynë në programin e ri-integrimit të D&E-së. Shumë të mitur nga kjo kategori mund të jenë tejkaluar pa u vënë re ose nuk kanë marrë ndihmë për shkak të mungesës së shërbimeve të duhura në Shqipëri.

Disa djem u identifikuan nga Njësia Lëvizëse, një mekanizëm i ngritur së fundmi me qëllim përmirësimin e identifikimit proaktiv të viktimave të trafikimit. Njësia Lëvizëse punoi jo vetëm për identifikimin praktik të viktimave por edhe për rritjen e kapaciteteve identifikuese të agjencive dhe OJF-ve të ndryshme me të cilat bashkëpunojnë. Ky element i fundit kishte rëndësi parësore pasi edhe te profesionistët dhe punonjësit social koncepti i trafikimit të meshkujve ishte i ri ose nuk ishte marrë në konsideratë. Deri më sot, Njësitë Lëvizëse kanë identifikuar katër djem të mitur dhe një mashkull në moshë madhore.

Tabela 1.6 Institucionet dhe agjencitë e përfshira në identifikimin e meshkujve të trafikuar

Agjencia ose institucioni identifikues	Numri i meshkujve të identifikuar
OJF për mbrojtjen e fëmijëve	14
Njësia Lëvizëse Tiranë	5
Policia	2
IOM	2
Gjithsej	23

Agjenci të përfshira në proçesin e identifikimit kanë qenë organizatat LGBT dhe organizata që punojnë me të mitur në konflikt me ligjin. Komuniteti LGBT haset me probleme diskriminimi dhe shpesh përjashtohen nga komunitetet ku jetojnë dhe kjo i bën të cënueshëm ndaj trafikimit në shumë raste. Gjithashtu, për të miturit në konflikt me ligjin, sistemit i mungojnë shërbime cilësore dhe të qëndrueshme.

Vetëm dy prej djemve u referuan nga policia. Kjo ndodhte sepse policia i konsideronte këto si raste problematike dhe nuk e kishte eksploruar më në thellësi situatën e tyre për të zbuluar situatën e vërtetë dhe elementet e shfrytëzimit.

Në rastin e meshkujve filipinas, ata ishin në situatë urgjente dhe telefonuan Ambasadën Filipinase në Romë dhe IOM-in në Filipine. Atëherë, IOM Filipine telefonoi IOM Shqipëria dhe ata u shpëtuan.

Në rastin e burrit shqiptar të trafikuar për punë të detyruar në Afrikë, ai e denoncoi rastin në TV dhe pas shumë përpjekjeve u kontaktua nga Njësia Lëvizëse e Tiranës.

Ndërsa rritet numri i identifikimit të meshkujve si të trafikuar, procedura formale e identifikimit mbetet pas. Në Shqipëri, viktimat e trafikimit duhet të identifikohen formalisht nga oficeri i policisë anti-trafik dhe punonjësi social nga zyra rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, që u jep statusin e “viktims së trafikimit”. Megjithatë, deri tani vetëm 4 nga 23 meshkujt e trafikuar janë identifikuar formalisht; të tjerët janë përcaktuar si “viktima potenciale”. Kështu ka ndodhur edhe në raste shumë të qarta të trafikimit.

Duke filluar nga viti 2012, është bërë progres pozitiv për identifikimin e rasteve të viktimave të huaja të trafikimit. Në Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave gjatë 2012, Koordinator i Kombëtar Anti-trafik (KKAT) raportoi dy raste të viktimave meshkuj të huaj të trafikuar, të identifikuar si viktima të trafikimit: “Këta ishin dy shtetas të huaj meshkuj nga Filipinet, të trafikuar në Kosovë dhe më vonë në Shqipëri me qëllim shfrytëzimin e tyre për punë në restorante si kuzhinierë.”¹¹

Të dy rastet u identifikuan formalisht si viktima të trafikimit në përputhje me Proçedurat Standarde të Veprimit.

¹¹ KKAT (2012) *Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave*, Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Koordinator i Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz.

7. Barrierat për identifikimin e meshkujve të trafikuar në Shqipëri

Ligjet dhe aktet nënligjore për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri

Para ngritjes së Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR), nenet për trafikimin në Kodin Penal ishin vetëm pika referimi për identifikimin e trafikimit. Këto nene u futën pas nënshkrimit të Protokollit të Palermos në 2001, dhe deri në 2013¹², reflektonin shqetësimin e Protokollit të Palermos për trafikimin e grave dhe fëmijëve, kishin të bënin me moshën, gjininë dhe llojin e shfrytëzimit. Kështu, kishte vetëm një nen për trafikimin e personave (110/a), një nen për trafikimin e femrave për prostitucion (114/b) dhe një nen për trafikimin e fëmijëve (128/b).¹³ Ligji i përfshin burrat, sepse neni 110/a nuk bën dallim, por fakti që kishte 2 nene të veçanta për femrat dhe fëmijët ka ndikuar në orientimin e profesionistëve të fokusohen te kjo kategori.

Ndryshimet e fundit në Kodin Penal me Ligjin Nr. 144/2013¹⁴, pritet të ndihmojnë për identifikimin e viktimave të trafikimit nga ana e agjencive ligjzbatuese – policia dhe prokuroria – pasi përveç rritjes së dënimit për krimin e trafikimit, ato përfshinin shfuqizimin e nenit për trafikimin e femrave për prostitucion dhe futjen e trafikimit brenda vendit, gjë që do të ndihmojë për identifikimin e trafikimit të meshkujve sepse: para miratimit të këtyre ndryshimeve, pasja e një neni të veçantë për trafikimin e femrave për prostitucion ndikonte disi te agjencitë ligjzbatuese që shikonin se kishin bazë ligjore vetëm trafikimin e femrave.

Së dyti, përfshirja në këto ndryshime e nenit për trafikimin brenda vendit përmirësoi identifikimin e meshkujve të trafikuar. Nga përvoja e ndihmës për viktimë meshkuj të trafikimit në Shqipëri, pjesa më e madhe e djemve të rinj janë shfrytëzuar brenda vendit. Prandaj, ndryshimi i nenit mund të ndihmojë gjatë procesit të njohjes formale të viktimave meshkuj të trafikimit. Kjo mund të vijë se rrjedhë e faktit se në shumë legjislacione, trafikimi lidhet ngushtësisht me shfrytëzimin seksual dhe më pak me trajta të tjera shfrytëzimi, si për shembull puna e detyruar. *Surtees* ka cituar

12 Ligji Nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995” Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë”

13 Ligji Nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, Datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë”

14 Ligji Nr. 144/ 2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, Datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë”

në studimin e saj¹⁵ se si legjislacioni i vendeve të tilla si Holanda, India apo Shoqata e Azisë Jugore për Bashkëpunim Rajonal (SAARC) i ka dhënë më shumë fokus trafikimit të grave dhe fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe vetëm së fundmi e kanë zgjeruar fokusin e trafikimit. Legjislacionet e vendeve e përjashtojnë identifikimin e meshkujve duke i dhënë fokus vetëm shfrytëzimit seksual dhe duke lënë mënjanë trajta të tjera të dëmshme të shfrytëzimit si ai për punë. Në të njëjtin studim, Surtees citon “*dështimi për ta shtrirë zbatimin e përpjekjeve anti-trafik përtej shfrytëzimit seksual, mohon në mënyrë efektive dëmin e shkaktuar personave të trafikuar për qëllime të tjera, shumë prej të cilëve mund të jenë burra.*”¹⁶

Kuadri institucional dhe veprimet për identifikimin në Shqipëri

Në Korrik 2005, qeveria shqiptare ngriti Mekanizmin Kombëtar të Referimit (MKR) për përmirësimin e identifikimit dhe ndihmës për viktimat e trafikimit. MKR-së iu bashkëlidh një format/strukturë interviste, për përcaktimin e rasteve të viktimave femra dhe të mitur në pikat e kalimit të kufirit dhe nuk ka asnjë referencë për rastet e meshkujve. Kjo do të thotë se në këtë periudhë, trafikimi shihej si një dukuri që prekte vetëm femrat dhe instrumentet e identifikimit ishin ndërtuar vetëm për këtë kategori.

Në Korrik 2011, Këshilli i Ministrave miratoi “Procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”. Siç shprehet në këto procedura, qëllimi i aktorëve kontribuues ishte identifikimi dhe referimi në kohën dhe mënyrën e duhur e të gjitha viktimave të trafikimit, në moshë madhore a të mitur, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, në vend a jashtë, të lidhur apo jo me krimin e organizuar¹⁷, përfshirë viktimat meshkuj të trafikimit. Megjithatë, vetëm pak agjenci e zbatuan këtë, kryesisht sepse trafikimi gjithmonë shihej i lidhur me femrat dhe fëmijët, siç shpjegohet më poshtë.

Dokumenti rendit disa agjenci përgjegjëse për identifikimin në territor, duke e forcuar rrjetin me ato që kanë potencial për të kontaktuar viktimat e trafikimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës, klinika publike të shëndetit, shkolla, rezidenca publike për fëmijë, njësi të mbrojtjes së fëmijëve, etj.

Një organ monitorues për Mekanizmin Kombëtar të Referimit me përfaqësues nga secili anëtar nënshkrues nuk është mbledhur akoma për të identifikuar çështjet e drejtuar drejt zgjidhjeve për zbatimin e PSV-ve.

15 Surtees, Rebecca (2008) ‘Trafficked Men as Unwilling Victims’, *St Antony’s International Review*, 4(1).

16 Surtees, Rebecca (2008) ‘Trafficked Men as Unwilling Victims’, *St Antony’s International Review*, 4(1), p. 19.

17 VKM nr.582, datë 27.7.2011 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.

Në Qershor 2012, MKR-ja u rinovua me nënshkrues të rinj, ku iu bashkuan agjenci të tjera shtetërore dhe një organizatë ndërkombëtare.

Aktualisht, pas rishikimit të MKR-së, nënshkruesit që kanë detyrime nga kjo marrëveshje janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (Shërbimi Social Shtetëror), Ministria e Punëve të Jashtme (Drejtorja Konsullore), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Qendra Kombëtare e Pranimi të Viktimave të Trafikimit në Tiranë, organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, Qendra Psiko – Sociale “Vatra” në Vlorë, “Tjetër Vizion” në Elbasan, ARSIS, dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Tiranë.

Asnjë progres nuk u bë në 2012 për identifikimin e rasteve të trafikimit brenda vendit nga ana e autoriteteve shtetërore. Në të njëjtin raport për vitin 2012, KKAT informon se për periudhën janar – dhjetor 2012, nuk ka pasur raste të trafikimit brenda vendit dhe kjo situatë është rrjedhojë e interpretimit të Vendimit Unifikues Nr. 3, datë 24.01 2011 i Gjykatës së Lartë që nuk e pranon konceptin e “trafikimit brenda vendit”. Gjatë vitit 2013, neni për trafikimin u ndryshua duke i dhënë fund konfliktit midis trafikimit ndërkombëtar dhe trafikimit brenda vendit.

Po ashtu, në Korrik 2013, u ngritën 3 Njësi Lëvizëse me qëllim identifikimin e viktimave të trafikimit nëpërmjet punës proaktive në terren. Skuadra lëvizëse përbëhej nga dy punonjës social me synim identifikimin e viktimave potenciale të trafikimit në mënyrë[proaktive. Metodologjia e Njësisë Lëvizëse u mbështet në kontaktimin drejtpërdrejt me komunitetet e pambrojtura dhe me rritjen e kapaciteteve të agjencive të tjera për identifikimin e VPET nëpërmjet trajnimeve dhe identifikimit të përbashkët të VeT në komunitetet tyre. Gjatë 2013, u identifikuan 38 viktima potenciale të trafikimit nga Njësitë Lëvizëse në Vlorë, Tiranë dhe Elbasan. Ndërsa gjatë Janar 2014 – Tetor 2014, Njësitë Lëvizëse identifikuan 41 viktima potenciale të trafikimit. Disa prej rasteve ishin adoleshentë apo të rinj meshkuj të shfrytëzuar për qëllime të ndryshme si për shfrytëzim seksual apo veprimtari kriminale.

Inspektorët e punës

Procedurat Standarde të Operimit (PSV) u dhanë një rol të dukshëm Inspektorëve të Punës për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit, dhe pritej që puna e tyre të ndihmonte për identifikimin e punës apo shërbimeve të detyruara – e rrjedhimisht një identifikim më të mirë të viktimave meshkuj të trafikimit. Deri tani, ndonëse janë Inspektorët e Punës janë trajnuar për zbatimin e PSV-ve, nuk ka pasur asnjë rast të trafikimit të fëmijëve apo të të rriturve të identifikuar nga Inspektorët e Punës.

Të kuptuarit se çfarë është puna e detyruar konsiderohet si një pengesë e rëndësishme për identifikimin, veçanërisht njohjen, e trafikimit dhe shfrytëzimit të meshkujve. Në të vërtetë, problemi i të kuptuarit të punës së detyruar përmendet në raportin e ILO në vitin 2005: “Që prej Raportit Global më të fundit për këtë çështje, është kuptuar gjithmonë e më shumë se puna e detyruar në trajtat e saj të ndryshme mund të përshkojë të gjitha shoqëritë, si në vendet në zhvillim edhe ato të industrializuara dhe nuk kufizohet kurrësi vetëm në disa qoshe të globit. Megjithatë, vetë koncepti i punës së detyruar, i parashikuar në standardet e ILO-s për këtë çështje nuk është kuptuar mirë. Në shumë qarqe, ky term vijon të shoqërohet me praktikën e punës së detyruar të regjimeve totalitare: abuzimet flagrante në kohën e Gjermanisë kur sundonte Hitleri, apo në kohën e Stalinit në Bashkimin Sovjetik ose të Pol Potit në Kamboxhia. Nga ana tjetër, terma të tillë si “skllavëri moderne”, “praktika skllavërie” dhe “punë e detyruar” mund të përdoren në një kuptim të tejet të gjerë për t’iu referuar kushteve të pafavorshme të punës, përfshirë edhe pagat shumë të ulëta.”¹⁸

Një arsye tjetër është se nuk ka udhëzues specifikë të komunikimit dhe as kontakt të qenësishëm me punëmarrësit. Një urdhër i ministrit për “Rregulla të veçanta për inspektorët dhe kontrollorët e punës”¹⁹ fokusohet në udhëzimet për komunikimin e inspektorëve të punës me punëdhënësit, jo me punëmarrësit. Siç informon intervista, pjesa më e madhe e kohës së inspektorëve dhe kontrollorëve përdoret me instruktimin e punëdhënësve për dokumentacionin dhe kontakti kufizohet ose me pronarët ose me administratorët e biznesit. Ndonëse faqja zyrtare e inspektoratit ofron një dritare për paraqitjen dhe raportimin e ankesave online, faqja e shërbimeve specifike ofrohet për punëdhënësit por jo për punëmarrësit.²⁰

Inspektimi i punës raportohet ose se nuk është kuptuar apo konsiderohet si më pak i rëndësishëm se inspektimet e tjera. Pjesa më e madhe e burimeve informon se bizneset nuk e kuptojnë rolin e inspektorëve të punës; ata i identifikojnë me inspektorët e shëndetit apo inspektorët tjerë, kryesisht inspektorët e tatimeve. Madje qarkullojnë anekdota në lidhje me lehtësimin e biznesmenëve/punëdhënësve kur marrin vesh se këta inspektorë nuk vijnë nga tatimet.

Gjithashtu, informohet se burimet njerëzore për inspektimet janë të kufizuara. Në një intervistë për “Vizion Plus” TV, drejtori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punës, e informoi gazetarin se janë rreth 80000 biznese të licencuara në vend, ndërsa janë vetëm 121 inspektorë të punës. Secili inspektor duhet të kryejë 15 inspektime në

18 ILO , A Global Alliance Against Forced Labor, *Global Report under the Follow-up to the ILO declaration on Fundamental Principles and rights at Work*, 2005

19 Urdhër i ministrit Nr. 1014. Date 30.5.2007’ “Rregulla të veçanta për inspektorët dhe kontrollorët e punës” aksesuar në: www.sli.gov.al

20 Faqja Zyrtare e Inspektoratit Shtetëror të Punës www.sli.gov.al

muaj, që do të thotë se gjatë vitit mund të inspektohen vetëm 22000 biznese formale, pak më shumë se një e katërta e tyre.

Ndërkohë, Inspektorati i Punës nuk ka mandat për inspektimin e punësimit informal, ndërkohë që ky nivel në Shqipëri është i lartë. Sipas UNDP-së, norma e papunësisë të rinjtë 15–29 vjeç është 24.3 për qind, dhe deri në 70 për qind e të rinjve janë të punësuar informal.²¹

Së fundi, më 21 Tetor 2014 u nënshkrua një marrëveshje midis Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit për raste të shfrytëzimit për punë.” Arritja e kësaj marrëveshjeje të rëndësishme dhe ngritja e grupeve të punës me pjesëmarrës nga institucionet e mësipërme pritet të rrisë identifikimin proaktiv të rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit. Pritet që kjo të rrisë rolin e inspektorëve të punës për identifikimin e VeT të trafikuar për punë të detyruar, si rrjedhojë numrin e meshkujve VeT të identifikuar.

Mungesa e njohurive që kanë profesionistët për forma të tjera të trafikimit

Fokusi dhe vëmendja e pjesës më të madhe të identifikimit në Shqipëri është për gratë dhe fëmijët e trafikuar, kryesisht për shfrytëzim seksual. Profesionistë dhe agjenci të ndryshme kanë kapacitete të kufizuara përfshirë policinë, shërbimet sociale, psikologët e shkollave, personelin shëndetësor, inspektorët e punës.

Më tej, moskonsiderimi i trafikimit të meshkujve si një shqetësim po aq i madh sa trafikimi i femrave dhe fëmijëve ka bërë që agjencitë të organizojnë më pak trajnime mbi trafikimin e meshkujve, duke zvogëluar kapacitetet për identifikimin e meshkujve nga ana e agjencive që mund të jenë në kontakt me ta.

Punonjësit socialë të Njesisë Lëvizëse të Tiranës thanë se në trajnimet e organizuara për OJF të ndryshme që punojnë me grupe në vështirësi, trafikimi më së shumti lidhej me shfrytëzim për qëllime seksuale dhe lypjen nga ana e fëmijëve. Puna e detyruar u përmend rrallë nga punonjësit socialë.

Në disa raste kishte vështirësi edhe nga policia për ta konsideruar punën e detyruar të lidhur me trafikun. E njëjta situatë është edhe për viktimat femra të shfrytëzuara për punë të detyruar. Një grua u referua në polici nga Njësia Lëvizëse. Sipas NjL-së

²¹ Supporting Decent Work Opportunities for Young Albanians:

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/ourwork/povertyreduction/successstories/supporting-decent-work-opportunities-for-young-albanians/>

dhe PSV-ve, kjo grua ishte viktimë trafikimi për punë të detyruar por për policinë ajo nuk ishte viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Në fund, edhe pse dha një intervistë formale dhe bëri denoncim, ajo nuk u identifikuar si VeT dhe rrjedhimisht nuk u konsiderua si rast trafikimi.

Perceptime të vulnerabilitetit

Mosidentifikimi i burrave mund të lidhet edhe me normat sociale të vulnerabilitetit—burrat janë të fortë ndaj nuk mund të jenë viktima. Menaxherët e rastit të intervistuar për këtë studim tregojnë se edhe në disa prej rasteve të asistuara, është vërejtur rezistencë në pranimin e faktit se ishin viktima të trafikimit apo të shfrytëzimit. Kjo është një prej arsyeve pse djemtë refuzojnë të njihen si viktima formale të trafikimit. Një nga menaxherët e rastit të intervistuar tregoi për një prej djemve të shfrytëzuar për qëllime seksuale kur ishte vetëm 14 vjeç. Pasi i tregoi historinë, menaxheri i rastit e pyeti nëse donte t'i denonconte trafikuesit në polici dhe ai u përgjigj 'absolutisht jo, do turpërohesh po ta merrte vesh polici se jam shfrytëzuar seksualisht. Edhe nëse një ditë vendos që ta denoncoj historinë në polici, dua që t'ia tregoj një policeje femër'".

Në Shqipëri, kuptimi social i "burrërisë" dhe rolet tradicionale të burrave ndikojnë në kuptimin e të qenit "viktimë" dhe perceptimet e vulnerabilitetit. Për shkak se burrat konsiderohen se janë në gjendje të kujdesen vetë për veten (ndërsa gratë konsiderohen si më vulnerabël), sipas skemave sociale burrat "s'mund" të jenë viktima, sepse koncepti i të qenit "viktimë" i referohet dikujt që nuk mund ta mbrojë veten. Pikëpamja mbizotëruese, e zakonshme në shoqëri të tilla si ajo shqiptare është se burrat "s'mund" të jenë të pafuqishëm. Sipas Surtees "kjo është në përputhje me maskulinitetin në Ballkanin Perëndimor ku burri ideal pritët të mbrojë familjen, të ketë forcë karakteri, të jetë i suksesshëm, të mos jetë 'femëror, i dobët apo gay', dhe të jetë fizikisht i fortë."²² Prandaj, viktimat meshkuj të trafikimit e gjejnë veten në një situatë të paqartë: "Termi 'viktimë' nga njëra anë është i rëndësishëm për sa i takon njohjes së krimit apo dhunimit që ka pësuar personi. Në fushën e mbrojtjes të drejtave të njeriut, termi 'viktimë' përdoret për t'iu referuar dikujt që përjeton padrejtësi për të cilën shkelësi është përgjegjës dhe për të cilën personi i viktimizuar ka të drejtën e mbrojtjes, asistencës dhe zhdëmtimit. Nga ana tjetër, të jesh viktimë, nënkupton pafuqishmëri dhe brishtësi, gjë që nuk merret shumë mirë nga shumë persona të trafikuar."²³

22 Surtees, Rebecca (2008) 'Trafficked Men as Unwilling Victims', *St Antony's International Review*, 4(1), f. 24

23 Surtees, Rebecca (2008) 'Trafficked Men as Unwilling Victims', *St Antony's International Review*, 4(1), f. 25

Ky qëndrim ka dy pasoja: një parandalimi i identifikimit të viktimave meshkuj të trafikimit nga profesionistët që mund të bien në kontakt me ta, dhe tjetra është pengesa që kanë burrat për të kërkuar ndihmë apo ta konsiderojnë veten si 'viktima të trafikimit'. Kjo vihet re edhe në përvojën e ofruesve të shërbimit:²⁴ djem të rinj e kanë të vështirë të pranojnë faktin se kanë qenë viktima të trafikimit. Për shembull, një djalë i ri e kishte të vështirë ta konsideronte veten viktimë edhe pse ishte mashtruar nga persona të rritur që e kishin përdorur për të vjedhur; ai përfundoi i dënuar për vjedhje. Po sipas Surtees, një prej mënyrave për të justifikuar procesin e shfrytëzimit për viktimat meshkuj të trafikimit është mundësia për t'i asistuar ekonomikisht familjet e tyre gjatë procesit, edhe pse në rastin më të mirë, ata marrin vetëm një sasi të vogël parash nga i gjithë ky proces.

Shumë meshkuj nuk e shohin veten si viktima të trafikimit dhe mund të refuzojnë të identifikohen formalisht si të tillë.

Ka shumë arsye specifike në mbështetje të mungesës së vullnetit të meshkujve për t'u identifikuar dhe veçanërisht për t'u identifikuar formalisht si viktima të trafikimit. Disa prej meshkujve thanë se nuk e konsideronin veten viktima, duke shtuar se gjithçka e kishin bërë për familjen ose për të mbijetuar. Disa prej tyre nuk ishin në gjendje ta konsideronin veten si të shfrytëzuar sepse fitonin një sasi të ardhurash nga aktiviteti, ndonëse pjesën më të madhe e merrnin shfrytëzuesit.

Gjithashtu termi 'i shfrytëzuar' nuk përshtatet mirë me stereotipin e 'mashkullit tipik', i cili nuk mund të jetë viktimë dhe nuk mund ta shfrytëzojnë nëse është mjaft trim. "Po ashtu, terminologjia e 'viktimitës së trafikimit' dhe ndërtimi social i të qenit 'viktimitë' mund të bëjë që disa burra ta kenë problem ta pranojnë dhe ta zbatojnë në situatën e tyre. Si e tillë, nuk ka të bëjë vetëm me faktin se çfarë shërbimesh dhe ndërhyrjesh hartohen, por edhe se si janë kuadruar dhe ofruar këto ndërhyrje për meshkujt e trafikuar."²⁵

Kjo është vërejtur në kontekste të tjera të trafikimit, ku burrat ka shumë të ngjarë të perceptohen si migrantë të dështuar dhe gratë si viktima të trafikimit.²⁶ Thënë ndryshe:

24 Intervista me menaxherët e rasteve.

25 IOM, Seritë hulumtuese për migracionin (IOM Migration research series), No 36, "Trafficking of men – a trend less considered The case of Belarus and Ukraine", Rebecca Surtees, www.iom.int

26 Surtees, Rebecca (2008) 'Trafficked Men as Unwilling Victims', *St Antony's International Review*, 4(1).

Në diskutimin dhe praktikën anti - trafik, këto presupozime për gjininë, migrimin dhe vulnerabilitetin duket të jenë theksuar në mënyrë të tillë që femrat migrante subjekt i shfrytëzimit shpesh konceptohen si të trafikuar, ndërsa meshkujt migrantë që përballen me të njëjtat dhunime dhe abuzime shihen shumë si migrantë të parregullt²⁷.

Kjo përputhet me një gjetje të një studimi në Evropë dhe Euroazi ku hulumtuesit në Serbi gjetën se burrat dhe gratë që përballëshin me të njëjtën situatë u trajtuan shumë ndryshe: për burrat dhe gratë e identifikuar në të njëjtin grup dhe në të njëjtat rrethana, “burrat [u] akuzuan për shkelje të rregullave të imigrimit, ndërsa gratë, jo vetëm që nuk u akuzuan, por iu dha leje qëndrimi e përkohshme”.²⁸ Sipas të intervistuarve në Mbretërinë e Bashkuar, “Shqipëria shihet shpesh si problem për çështje të trafikimit dhe krimeve të tjera; megjithatë, në të vërtetë ata nuk përfaqësojnë një numër të madh të atyre që kryejnë krime në Londër”. Identifikimi i viktimave meshkuj shqiptarë konsiderohet se pengohet nga dyshimi për kriminalitetin nga ana e migrantëve shqiptarë, jo domosdo i mbështetur në fakte. Kjo tregon se në shumë raste, meshkujt shqiptar jo vetëm që perceptohen si jo vulnerabël, po kur janë migrantë jashtë shpesh perceptohen si shkelës e kriminelë – qoftë për shkak të migrimit të parregullt apo presupozimeve për kriminalitetin nga shqiptarët.

Paqartësia në dallimin midis migrimit të parregullt dhe trafikimit

Një tjetër sfidë e rëndësishme e hasur gjatë procesit të identifikimit të viktimave meshkuj të trafikimit është fakti se në shumë raste të punës së detyruar, viktimat e trafikimit ose viktimat potenciale të trafikimit konsiderohen si migrantë të parregullt dhe dëbohen pa marrë parasysh mundësinë se ata mund të jenë shfrytëzuar. **Rosenberg** thotë “...pjesa më e madhe e burrave janë trafikuar për punë, sidomos ata që kanë hyrë dhe punojnë në atë vend në mënyrë të paligjshme, konsiderohen së pari si migrantë të parregullt dhe dënohen dhe dëbohen për këtë pa marrë parasysh statusin e tyre potencial si persona të trafikuar”.²⁹ Gjithashtu **Surtees** citon se përvojat e këqija të shfrytëzimit shpesh riformulohen nga viktimat jo si situata trafikimi po si përvoja migrimi të pasuksesshme, “... shfrytëzimi i tyre shihet zakonisht si një aspekt normal

27 Surtees, Rebecca (2008) ‘Trafficked Men as Unwilling Victims’, *St Antony’s International Review*, 4(1), p. 17.

28 Rosenberg, Ruth (2010) *Trafficking of Adult Men in the Europe and Eurasia Region: Final Report*, USAID and Creative Associates International, f. 6-7.

29 Rosenberg, Ruth (2010) *Trafficking of Adult Men in the Europe and Eurasia Region: Final Report*, USAID and Creative Associates International, f. 20.

punës së migrantit, apo si ‘fat i keq’ më shumë se sa një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut.’³⁰

Një nga vështirësitë që raportohet shpesh për identifikimin e rasteve të trafikimit, përfshirë meshkujt, është se trafikuesit zbatojnë metoda më komplekse dhe “të padukshme” shtrëngimi, të cilat japin përshtypjen se personat e trafikuar janë të lirë dhe bashkëpunëtorë të vullnetshëm në krime dhe shkelje. Në rastin e viktimave meshkuj të trafikimit, ky stereotip mbështetet nga stereotipe të tjera pasi, për shembull, meshkujt, ndryshe nga gratë dhe fëmijët, nuk mund të jenë viktimë të shfrytëzimit sepse janë në gjendje të vetë mbrohen. Një tjetër vështirësi është të kuptuarit e abuzimit të vulnerabilitetit, sidomos e varësisë ndaj drogës dhe alkoolit. Një nga informatorët e studimit e konsideron të vështirë ta njohësh si viktimë një burrë që është i varur nga alkooli.

Një sfidë tjetër për identifikimin e viktimave meshkuj të trafikimit ishte mungesa e informacionit që shoqëron kthimin e detyruar.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) informoi në 2009 se “*Megjithë progresin e bërë, një prej problemeve të hasura nga KSHH gjatë monitorimeve ishte moszbatimi i dispozitave për marrëveshjet e ripranimit në lidhje me të kthyerit në Shqipëri nga vende të treta. Kthimi i migrantëve të parregullt nga vende të tjera bëhet pa njoftim paraprak dhe pa dokumentet e nevojshme të përkthyer në të dyja gjuhët – procedura që janë të domosdoshme për të garantuar të drejtat e të kthyerve.’³¹ Po të respektoheshin procedurat, do to ishte i mundur një vlerësim më i mirë i situatës së migrantëve të parregullt.*

Mungesa e besimit; refuzimi për t’u identifikuar

Një pengësë tjetër për identifikimin është mungesa e besimit te autoritetet. Në Shqipëri, identifikimi formal si viktimë e trafikimit kërkon një intervistë formale me policinë (me një oficer të njësisë anti-trafik) së bashku me një punonjës social nga Shërbimi Social Shtetëror.³² Shumica e meshkujve të intervistuar për këtë studim kishin perceptim negativ për policinë. Pjesa më e madhe e djemve të intervistuar ishin fëmijë të përfshirë në situatë rruge dhe për shkak të kësaj situatë ishin zakonisht të parët që shoqëroheshin apo merreshin në pyetje nga policia kur vidhej diçka në

30 Surtees, Rebecca (2008) ‘Trafficked Men as Unwilling Victims’, *St Antony’s International Review*, 4(1), f. 24.

31 Ersida Sefa : Komiteti Shqiptar i Helsinkit *The rights of Albanian Emigrants and Returnees in Albania* <http://www.socialwatch.eu/2009/documents/Albania.pdf>

32 VKM (2011) No. 582 ‘Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme/viktimave të trafikimit’, dt 27.7.2011.

lagje apo nëse policisë i duhej ndonjë informacion. Kjo i bënte të zhvillonin një sens frike dhe mosbesimi ndaj policisë.

Stigma e trafikimit për shfrytëzim seksual

Ata që shfrytëzoheshin seksualisht nuk ishin të gatshëm të flisnin hapur në polici për përvojën e trafikimit. Disa prej tyre kishin frikën e paragjykitimit dhe stigmës që mund të shoqëronte procesin, frikë se dikush nga familja mund të mësonte çfarë kishte ndodhur dhe frika se ata mund të marrin vesh orientimin e ndryshëm seksual, në disa raste. Gjithashtu, në lidhje me shfrytëzimin seksual të djemve, tema konsiderohet si tabu kulturor për shumë shoqëri, dhe për djemtë është tejet e vështirë të ndajnë këtë përvojë të dhimbshme. Në shumë raste, ata vendosin të heshtin dhe ta konsiderojnë këtë traumë si një pjesë të errët e të paeksploruar të së shkuarës së tyre.

Vetëfajësimi i djemve: Sipas përvojës së ofruesve të shërbimeve, ka shumë djem që fajësojnë veten për atë që u ka ndodhur.

Përveç këtyre, duhet marrë në konsideratë presupozimet rreth homoseksualitetit kur përfshihen në prostitucion (konfuzion ndër djemt).

Frika nga trafikuesit

Frika nga pasoja të mundshme është një arsye tjetër që në disa raste ata e mohojnë që kanë qenë të shfrytëzuar apo refuzojnë të japin emrin e shfrytëzuesit.

Një prej arsyeve që një nga djemtë nuk e denoncoi trafikuesin ishte se besonte që ai ka bashkëpunëtorë të rrezikshëm. Edhe pse vetë mund të dënohej me burg, ai mund të përdorte miqtë e tij për ta kërcënuar djalin apo familjen e tij.

Intervistat me menaxherët e rastit tregojnë se edhe rastet që denoncojnë trafikuesit, shprehen se përsëri ndihen të kërcënuar.

Analizimi i migrantëve – të kthyer ose të huaj

Ashtu si thotë thënë një ekspert për migrimin³³, nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, migrimi është një veprimtari e rrezikshme në vetvete dhe pavarësisht shpërblimet dhe përfitimet e mundshme, këmbimi i të njohurës me të renë e panjohur dhe statusin e një qytetari të vendit tënd me atë të shtetasit të huaj në një botë ku shteti është ende garantuesi i të drejtave, përfshin sfida materiale, sociale

33 Jacqueline Bhabha “ Trafficking, Smuggling, and Human Rights” <http://www.migrationinformation.org/Feature/display.cfm?ID=294>

dhe psikologjike. Këto rreziqe shtohen kur ndërthuren me statusin e të parregulltit.

Në pjesën më të madhe të intervistave të kryera për këtë studim, në pikën e kalimit të kufirit në Kapshticë, me migrantë të dëbuar që kishin punuar në bujqësi në Greqi, u vunë re elemente të kushteve tejet të papërshtatshme të strehimit dhe punës. Për shembull, një grup i madh njerëzish që jetonin në një kasolle dhe punonin për 12-13 orë si barinj apo druvarë, pa qasje në kujdes shëndetësor, pa siguracion, dhe me pagesa të ulëta duke pasur parasysh orarin e gjatë dhe sasinë e punës gjatë ditës.

Analizat e intervistave të bëra për studimin tregojnë se në shumë raste ka tregues të qartë të shfrytëzimit për punë si për shembull kushte pune dëmtoese, mungesa e qasjes në kujdes shëndetësor, mosrepektim i marrëveshjes së bërë më parë për pagesën dhe kushtet e punës, dhe në shumicën e rasteve mungesa e dokumenteve ligjore si leja e qëndrimit e bënte situatën e tyre edhe më të pambrojtur.

Rishikimi i literaturës dhe intervistat nxjerrin në pah një sërë vështirësish me të cilat ndeshen autoritetet e kufirit, ndër kryesoret ajo e fluksit të madh të të kthyerve.

Qeveria priste numër të lartë të të kthyerve, të paktën deri në vitin 2015. Një prej masave të parashikura në Planin Kombëtar të Veprimit për ri-integrimin e të kthyerve shqiptarë është sigurimi i transportimit nga Pikat e Kalimit të Kufirit (PKK) në qendrat më të afërta urbane dhe, në rastin e grupeve vulnerabël, në qendrën më të afërt urbane me vendbanimin e tyre. Qeveria pret që të rikthyerit të jenë rreth 150 persona në ditë në tre PKK-të kryesore, dhe gjithsej priten rreth 60000 të kthyer në vit³⁴

Një numër i madh e të kthyerve janë, siç quhen në PKK “përsëritës”; ata udhëtojnë disa herë gjatë vitit. Shumë prej tyre ishin të mitur. Tre nga gjashtë të rikthyerit të intervistuar në Kapshticë (ktheheshin nga Greqia) informuan se ishin të mitur kur migruan për herë të parë. Një prej të kthyerve të intervistuar tregoi këtë histori:

“Shkova në Greqi kur sapo mbusha 16 vjeç. Ndenja atje tre vjet dhe u ktheva në Shqipëri. Ndenja një muaj në Shqipëri dhe shkova përsëri në Greqi. Për pak mbush dy vjet që jam në Greqi. Herën e parë shkova nga mali. Punova si elektrikist. Ndenja te vëllai, ai jetonte atje”.

Një tjetër migrant, kur u pyet sa shpesh shkon në Greqi, u përgjigj: “Varet, kushërinjtë e mi në Greqi janë me karta dhe më marrin në telefon e më thonë kur ka punë”. Lëvizja e shpesh të informohet se e rrit mbingarkesën e punës së personelit të PK, por edhe ul vigjilencën ndaj përvojave të ndryshme që mund të kenë patur secilën herë.

³⁴ <http://www.asp.gov.al/images/pdf/plani-veprimit-shtetasit-kthyer.pdf>

Kushtet në të cilat personat u dëbuan informohet se sfidojnë burimet e Policisë shqiptare të Kufirit. Në shumë raste, ata janë mbajtur në qendra të paraburgimit për ditë me rradhë dhe kanë udhëtuar për orë të tëra deri sa kanë mbërritur.

Me liberalizimin e vizave, numri i atyre që përpiqen të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme ka rënë ndjeshëm. Sipas KKAT³⁵, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012, autoritetet kanë interceptuar 351³⁶ persona që përpiqeshin të kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme. Ndërsa sipa të njëjtit raport, 1025 u interceptuannë kufi gjatë 2013.

Megjithatë, ka lindur një vështirësi e re: identifikimi i viktimave potenciale të trafikimit ndër individët që dalin nga vendi në mënyrë të ligjshme informohet të jetë i vështirë dhe mbart rrezikun e shkëljes së të drejtave të shtetasve shqiptare³⁷.

Të huajt në Shqipëri janë një grup tjetër për të cilët janë mbledhur të dhëna të kufizuara gjatë këtij vrojtimi. Analizimi i migrantëve të parregullt që hyjnë në Shqipëri është kuadruar që herët. Analizimi paraprak u formalizua si procedurë në Shkurt 2001 nëpërmjet një marrëveshjeje midis Ministrisë së Rendit Publik, UNHCR-së, Oranizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Qëllimi i procedurës ishte trajtimi i nevojës për identifikimin e të huajve që kishin nevojë për ndihmë dhe synonte uljen e mundësisë që personat të largoheshin, në kundërshtim me normat ligjore nga Shqipëria. Në 2004, autoritetet shqiptare për refugjatët dhe azilin konsideruan se *“Shqipëria nuk është domosdoshmërisht një pikë tranziti për në Evropën Perëndimore dhe se interesi kryesor i një azilkërkuesi apo refugjati është t’i largohet persekutimit nga vendi i origjinës, pavarësisht nëse vendi pritës është në kushte të pasura apo të varfra. Dhe ne jemi këtu për të siguruar që azilkërkuesve të mirëfilltë t’u jepet mbrojtje.”*³⁸ Në Mars 2006, me nënshkrimin e MM-së, partnerët ndërkombëtarë ia dorëzuan Ministrisë së Brendshme Shqiptare.³⁹

Gjatë vitit 2012, në Shqipëri ishin 7351 të huaj rezidentë të ligjshëm, nga të cilët, 2861 për arsye pune. Numri i atyre që vijnë për këtë qëllim vijon të rritet; vetëm në 2012, autoritetet shqiptare dhanë 2679 leje pune për shtetas të huaj, nga të cilat 2679 leje pune u dhanë për për herë të parë. Për shkak të krizës, u vu re një ndryshim gjatë 2012: një numër në rritje i shtetasve të huaj kërkojnë të vijnë në Shqipëri si punëmarrës dhe jo si punëdhënës apo investitorë.

35 Raporti 2012

36 Nga këta, 16 ishin femra

37 Intervista me Policinë e Kufirit

38 Pre-screening in Albania helps identify new arrivals in need of protection **News Stories**, 6 August 2004 <http://www.unhcr.org/41137b194.html>

39 http://www.iomtirana.org.al/index.php?faqe=comp_project26

Nuk është e qartë se sa prej shtetasve të huaj punojnë pa leje pune. Profili i Migracionit informon se gjatë vitit 2010, nga inspektimi i 14642 subjekteve/bizneseve, u regjistruan gjithsej 1254 punonjës të huaj / jo shtetas dhe 210 prej tyre ishin pa leje pune.⁴⁰

Niveli i dërgesave në para nga Shqipëria konsiderohet si një tregues i trajtimit pozitiv dhe prosperitetit të të huajve në Shqipëri. Gjatë vitit 2011, rreth 50 milionë euro u dërguan nga Shqipëria në vendet e origjinës; nga këto, rreth 87% ose 43.8 milion ishin dërgesa nga shtetas grekë që punojnë në Shqipëri.⁴¹

Në vitin 2009, NATO u informua se Shqipëria ishte bërë një pikë e rëndësishme e tranzitit për në Evropën Perëndimore për migrantë që vinin nga Turqia, Iraku, Afganistani dhe Pakistani.⁴²

Raporti i KKAT për 2012, 2013 informon për një rritje të konsiderueshme të shtetasve të huaj nga Afrika e Veriut apo Azia që përpiqen të hyjnë në Shqipëri si tranzit drejt vendeve të zhvilluara evropiane. Raporti nuk jep një numër të tyre po informon se “megjithëse këto raste nuk rezultojnë si raste trafikimit, Policia e Kufirit tregon kujdes të veçantë gjatë intervistimit të tyre”.⁴³

Identifikim i pamjaftueshëm nga vendet e destinacionit

Informacioni i disponuar tregon se migrimi i shqiptarëve në BE për arsye pune do të vazhdojë dhe identifikimi dhe mbrojtja e viktimave shqiptare do të varet, në masë të madhe nga sistemi i identifikimit dhe mbrojtjes në vendet e destinacionit.

Një studim i kryer në 2010 nga Banka Botërore dhe ETF tregoi se shumica e shqiptarëve (65.8%) që synojnë të migrojnë do ta bënin këtë për arsye ekonomike. Nga ky numër 65.8 %, rreth 36.7% synonin të përmirësonin standardin e jetesës, 19.7% sepse nuk kishin punë/nuk mund të gjenin punë, 9.3% sepse natyra e punës ishte e pakënaqshme, 0.1% për të shlyer borxhet, për pagë më të lartë, ose për shkak të sistemit të pamjaftueshëm të sigurimeve shoqërore. Më tej informohet se sektorët ku shqiptarët të migrojnë përsëri dhe pritet të punojnë janë ato të shërbimit në familje, mikpritje dhe ndërtim.⁴⁴

40 Profili i migracionit në Shqipëri

41 <http://www.lajm-shqip.com/2013/04/shtohet-numri-i-te-huajve-te-punesuar-ne-shqiperi-ja-shifrat-burimi-ikub-al-www-ikub-al/>

42 ANTONIO CABRAS (ITALY) – Raportues në Asambenë Parlamentare të NATO-s, 100 GSM 09 E rev 1 - Migration in the mediterranean region: causes, consequences and challenges: <http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=1858>

43 Raporti KKAT 2012

44 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore 2010, Banka Botërore,

Migrimi qarkullues pritet të rritet në kontesktin e krizës. Rrjetet e migrantëve shqiptarë me tregjet lokale të punës në Greqi, afërsia me Shqipërinë dhe regjimi pa viza janë faktorë shtesë që e mbështesin këtë argument.⁴⁵

Marrë në konsideratë flukset e larta të migrantëve shqiptarë me qëndrim të parregullt në Itali dhe Greqi, pjesa më e madhe e përgjegjësishë për identifikimin lidhet me potencialin dhe gatishmërinë e këtyre vendeve destinacion për të identifikuar viktimat. Ka një sens të përbashkët të kuptuarit ndër informatorët në shqipëri se viktimat e trafikimit mund të identifikohen duke analizuar më mirë ndër migrantët e parregullt në Greqi dhe Itali: *”Duhet të ketë raste të trafikimit mes të të kthyerve, pjesa më e madhe e tyre kanë qenë me qëndrim të parregullt, ndaj edhe ekziston mundësia që të jenë trafikuar.”*⁴⁶

Intervistat në Shqipëri sugjeruan se grupet apo individët meshkuj migrues që kishin nevojë për t’u arritur dhe vlerësuar me kujdes janë ata të organizuar në punë sezonale të tilla si mbledhja e duhanit në Itali (më keq se minat – tha i intervistuari dhe është një bashkëkombës që merr përsipër punën dhe rekrutimin e punonjësve të tjerë), mbledhja e ullinjve në Greqi, dhe ata që punojnë në tregun e fruta-perimeve në Maqedoni. Një lloj tjetër pune kuy merr formë shfrytëzimi është ajo e bariut – fëmijë shqiptarë 16 vjeçarë në Gostivar kujdesen për dhentë gjatë verës, për të mbledhur para të mjaftueshme për të blerë çfarë u duhet për shkollë dhe kthehen në shtator.

Lëvizja e fëmijëve Shqipëri – Kosovë. Një përshkrim i kohëve të fundit për fëmijët shqiptarë në situatë rruge në Kosovë sugjeron se fëmijë migrojnë së bashku me familjet në Kosovë, kryesisht për të lypur apo për të mbledhur metale ka gjithashtu të ngjarë të ekspozohen ndaj rrezikut të shfrytëzimit nga qarqe të krimit të organizuar për qëllime seksuale dhe pune të detyruar.⁴⁷

Të miturit në konflikt me ligjin

Një grup tjetër, situata e të cilëve duhet vlerësuar në brendësi, janë të miturit që janë në konflikt me ligjin apo të dënuar për veprimtari të detyruar kriminale, si për shembull vjedhja. Sipas intervistave të bëra me prokurorët që merren me çështje

ETF , Jesús Alquézar Sabadie, Johanna Avato, Ummuhan Bardak, Francesco Panzica, dhe Natalia Popova; Migration and Skills *The Experience of Migrant Workers from Albania, Egypt, Moldova, and Tunisia*

45 Anna Triandafyllidou , Metoikos Project, *Circular Migration and Integration A Short Guide for Policy Makers* Gjetet te: <http://www.eui.eu/Projects/METOIKOS/Documents/GuidePolicyMakers/METOIKOSGuideforPolicyMakers.pdf>

46 Intervistë me MPÇSSH

47 Mbrojtje e fëmijëve në lëvizje, dhjetor 2010, Observation Report: Exploitation of Albanian Children in street situation in Kosovo: http://s3.amazonaws.com/rcpp/assets/attachments/1197-Observation_Report_Exploitation_of_Albanian_Children_in_Street_Situation_in_Kosova_original.pdf

të të miturve, nuk ka raste të njohura zyrtarisht si shfrytëzim i të mirurve për veprimtari kriminale, por ata nuk e përjashtojnë faktin se të miturit mund t'i kryejnë veprat penale të shtyrë nga të rriturit. Një prej prokurorëve thotë “...si mundet që tre djem 15-16 vjeç që janë nga qytete të vogla në veri të Shqipërisë, vijnë në Tiranë, jetojnë në apartament me qira dhe vjedhin, pa qenë dikush që i drejton?...”. Sipas tyre, një punë më e kujdseshme duhet bërë nga ana e policisë gjatë hetimit të rastit. Bazuar në përvojën e ofruesve të shërbimit, ka shumë raste të viktimave meshkuj të trafikimit të shtyrë nga shfrytëzuesit e tyre për veprimtari kriminale si vjedhja apo shpërndarja e lëndëve narkotike, në moshat 11-16 vjeç.

Fatkeqësisht, në disa raste cases, ka pasur madje vendime gjyqësore që dënojnë viktimat meshkuj të trafikimit.

“D. është një djalë 16 vjeçar. Ai ka qenë në institucion që fëmijë. Më vonë, gjatë kohës që ishte në institucion, ra në kontakt me disa të rritur që e abuzuan dhe e shfrytëzuan seksualisht, duke përfutur nga vonesa e lehtë e zhvillimit të tij dhe traumat komplekse të të hershme të patrajuara. Njëri prej fajtorëve u dënua, ndërsa tjetri u lirua pas vetëm disa muaj ndalimi. Pas lirim, rivendosi kontakt me djalin duke ndikuar mbi të dhe duke e shtyrë të bëjë vjedhje. Për pasojë, djali u dënua me shërbim në komunitet”.

Ky është vetëm një prej rasteve që ka kaluar në procese dhe dënim gjyqësor. Në një rast tjetër, një prej djemve ishte shfrytëzuar për vjedhje po sistemi gjyqësor e dënoi me burg. Në një intervistë, një prej punonjësve sociale të Qendrës Psiko-sociale Vatra tha se ka vëretur probleme të ngjashme. Ajo përmendi rastin e një djali, kur punonte në sistemin e vuajtjes së dënimit si personel edukimi disa vite më parë. Djali ishte rreth 16 vjeç dhe ishte shfrytëzuar seksualisht në periferinë e një qyteti bregdetar në jug të Shqipërisë. Më vonë u dënua për vjedhje. Kur përfundoi në burg, tregoi për shfrytëzimin. Megjithëse u kontaktua, policia tha se nuk kishte prova të mjaftueshme. Gjithashtu, në një intervistë për këtë studim, një prokuror i çështjeve të të miturve tha se në praktikën e punës së tij ka shumë raste të dyshimta kur ‘djem të moshës 14,15 dhe 16 vjeç vijnë në Tiranë, marrin apartamente me qira dhe vjedhin’. Sipas prokurorit këto janë situata të çuditshme dhe policia duhet të hetojë më thellë për të parë nëse ka tregues të shfrytëzimit për veprimtari kriminale nga të rriturit që kontrollojnë këto grupe.

Edhe në raportin vjetor të KKAT⁴⁸ përmendet fakti që “në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet dispozita që mbrojnë pozicionin e viktimave të krimit në përgjithësi dhe viktimave të trafikimit në veçanti, gjatë procesit penal”

48 “Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave Janar-Dhjetor”- Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

Nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, kriminalizimi i viktimës është një dhunim i dyfishtë i të drejtave të njeriut. Së pari, sistemi i mbrojtjes, përfshirë Shërbimet Sociale, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Policia, OJF-të, etj, nuk sigurojnë mbrojtje dhe nuk parandalojnë viktimizimin e personit. Së dyti, jo vetëm që dështojnë në mbrojtjen e viktimës, por edhe e dënojnë viktimën.

8. Asistenca për viktimat meshkuj të trafikimit – nevoja dhe pengesa

Burrat dhe djemtë e trafikuar kanë një mori nevojash për asistencë pasi largohen nga situata e shfrytëzimit dhe përpiqen të rindërtojnë jetën dhe të vazhdojnë përpara. Disa janë nevoja urgjente në periudhën fillestare të krizës dhe disa janë nevoja për asistencë më afatgjatë.

8.1 Strehë dhe akomodim

Strehimi ishte nevojë urgjente për shumë prej burrave dhe djemve të trafikuar që kanë marrë ndihmë në Shqipëri. Në disa raste, si ato të filipinasve, kjo ishte një nevojë për shkak të faktit se shfrytëzoheshin në një vend destinacion dhe këta burra kishin nevojë për akomodim urgjent të përkohshëm, ndërsa merrnin ndihmë në Shqipëri, dhe bëheshin gati dokumentet dhe përgatitjet e tjera për rikthimin e tyre.

Në raste të tjera, kishte nevojë për të identifikuar dhe siguruar akomodim afatgjatë për burrat dhe djemtë e trafikuar, disa prej të cilëve kishin qenë të pastrehë para se të trafikoheshin.

Në pjesën më të madhe të rasteve, nevoja më bazike për djemtë viktimë të trafikimit të asistuar nga D&E-ja është strehimi. Për të paktën 18 nga 20 djemtë e rinj të asistuar, strehimi ishte nevoja më bazike në fillim të procesit. Kjo nevojë kuptohet po të kemi parasysh se pjesa më e madhe e rasteve të asistuar kanë qenë më parë në situatë rruge, pa vendbanim të qëndrueshëm, apo vinin nga institucione, para se të fillonin procesin e ri-integrimit. Gjithashtu, familjet e tyre, në më të shumtën e rasteve, nuk kanë ndonjë pronë, dhe jetonin në shtëpi me qira apo vende të papërshtatshme. Politikat vendore dhe qeveritare në lidhje me strehimin e grupeve vulnerabel në Shqipëri janë ende të pamjaftueshme. Në këto kushte, parashikohet që nevoja për strehim do të jetë një nevojë bazike e vazhdueshme për djemtë shqiptarë viktimë të trafikimit si dhe një kërcënim për suksesin e procesit të ri-integrimit në rast se kjo nevojë nuk përmbushet.

Pavarësisht nga kjo, ka një hendek të madh në sistemin e shërbimeve sociale për të miturit në Shqipëri. Gjithashtu, përveç disa përpjekjeve nga disa OJF, sistemi i

familjeve kujdestare (*foster care*), që mund të ndihmojë në rastin e të miturve të larguar nga familja e vet apo e fëmijëve në familje abuzive apo neglizhente, nuk është ende i konsoliduar.

Ndërsa burrat e trafikuar për punë të detyruar zotërojnë prona në qytetet nga vijnë. Ndaj, pas përvojës së trafikimit janë kthyer në shtëpitë e tyre. Megjithatë, në rastin e të huajve, strehimi ishte një nevojë urgjente, deri sa ata vendosën të kthehen në vendin e origjinës.

8.2 Siguria

Sipas menaxherëve të rastit në D&E, të paktën katër prej rasteve kishin probleme për sigurinë. Dy prej tyre kishin frikë se shfrytëzuesit mund të hakmerreshin. Për dy të tjerët, situata ishte shumë më e ndërlikuar sepse ishin të mitur dhe, ndonëse ishin nën një program ndihme, vazhdonin të ishin në kontakt me shfrytëzuesit. Menaxherët e rasteve informuan se policia ishte njoftuar në këto raste por ata e kanë të vështirë të ndërhyjnë shpejt, sepse sipas tyre, ata duhet më parë të kryejnë hetime. Në të vërtetë, ka një mangësi në sistemin e legjislacionit për mbrojtjen e të miturve, sepse policia ndërhy vetëm kur ka prova të qarta se një i mitur po shfrytëzohet apo abuzohet.

Në rastin e meshkujve të rritur viktimë të trafikimit, ka dy situata të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë gjatë procesit të asistencës: siguria dhe kompensimi. Tre meshkujt e rritur, kishin frikë se diçka mund t'u ndodhte atyre vetë apo familjes, sepse ata kishin denoncuar, por trafikuesit ishin të lirë.

8.3 Asistenca psikologjike

Burrat dhe djemtë e trafikuar janë shpesh të traumatizuar nga përvoja e trafikimit.

Më tej, shumë djem të trafikuar janë të traumatizuar si pasojë e jetës së tyre para trafikimit, përfshirë abuzim dhe dhunë në familje, alkoolizëm brenda familjes, varfëri, neglizhim, braktisje, vdekje e njërit prind, etj.

Trauma të mbivendosura nga fëmijëria, probleme ekzistuese në familje që më parë, dhe shfrytëzim i përkthyer në disa probleme dhe modele të sjelljes përfshijnë:

- Vetëvlerësim të ulët, mungesë e aftësive të vetësigurisë, pasiguri, simptoma të ankthit dhe depresionit apo mendime për vetëdëmtim;
- Vështirësi në menaxhimin e zemërimit, impulsivitet dhe sjellje agresive;

- Mungesë qëndrueshmërie (marrëdhënie në nivele jo të duhura dhe të vështira, vështirësi për ndërtimin e planeve të qarta si dhe për ndjekjen e tyre deri në fund)

Ky disfunkcionim dhe vulnerabilitet jo vetëm që ka ndikuar mbi djemtë gjatë fëmijërisë por po aq ka kufizuar aftësinë e tyre në moshë të rritur për t'u përballur me sfidat.

Si pasojë, një prej aspekteve më të rëndësishme të procesit të ri-integrimit për djemtë e trafikuar në Shqipëri është dhënia e asistencës psikologjike.

Psikoterapia nuk është ende një profesion i rregulluar me ligj dhe është shumë i kushtueshëm, sepse ofrohet vetëm brenda sektorit privat të shërbimeve. Qendrat komunitare të shëndetit mendor vijojnë të kenë një standard të ulët dhe ofrojnë kryesisht shërbime psikiatrike vetëm për probleme të rënda psikologjike, si skizofrenia apo prapambetje të larta zhvillimore. Barra më e madhe e shërbimeve për viktimat e trafikimit vijon të mbahet nga OJF-të që punojnë me viktimat e trafikimit.

Një prej profesionistëve të intervistuar tregon se gjatë shërbimeve të këshillimit ata shfaqen herë shmangës, shumë të nervozuar dhe disa herë të shkëputur. Duket e vështirë për ata të vijnë në këshillim dhe të kërkojnë ndihmë. Rastet që janë asistuar me sesione këshillimi janë rezistentë. Ata harrojnë ditët e sesioneve, vijnë me vonesë apo nxjerrin justifikime për t'iu shmangur sesionit të këshillimit.

Një profesionist ka thënë se: “Kur njëri prej rasteve të asistuar që kishte qenë abuzuar në fëmijërinë e hershme u pyet për periudhën kur supozohej se ishte abuzuar, refuzoi të fliste për këtë përvojë dhe nuk u kthye për të paktën tre javë”.

Kur bëhet fjalë për shfrytëzimin seksual, është një çështje shumë e vështirë për ta rrëfyer. Madje edhe kur vendosin të tregojnë për përvojat e shfrytëzimit, duhet ende të sigurohen mirë që kjo nuk do të diskutohet me ndonjë person tjetër.

Përtej vështirësive psikologjike nga përvoja e shfrytëzimit, ka edhe çështje të tjera kulturore, që çojnë në këtë rezistencë. Çështje si turpi apo stigma e të qenit viktimë, meshkuj që kanë rënë në pozitën e viktimës janë çështje që ndikojnë në mënyrën se si djemtë e shohin veten dhe pozicionin e tyre aktual.

Çështje të tjera të vërejtura gjatë sesioneve të këshillimit psikologjik lidhen me vështirësinë e rasteve për t'u lidhur me emocionet, në veçanti ato negative. Për

shembull, disa prej djemve (sidomos ata që kishin jetuar në situatë rruge për një kohë të gjatë) tregojnë për ngjarje shumë traumatike në jetën e tyre, duke qeshur ose në një gjendje krejt neutrale. Kjo mund të vijë si pasojë e traumave të pësuar.

Menaxheri i rastit i D&E tregon: “Një prej rasteve ndërkohë që fliste për një ngjarje traumatike të jetës së tij dhe humbjen e njërit nga prindërit kishte të njëjtën shprehje fytyre (buzëqeshje) gjatë gjithë sesionit, që nga fillimi deri në fund.”

“Gjatë intervistës fillestare me një prej djemve, ai qeshte dhe tregonte se si i ati e rrihte me rrip mes vazhdimisht. Kur u pyet si ndihej kur e tregonte këtë, ra në heshtje dhe ndryshoi temën e diskutimit.”

Gjithashtu, rastet që janë rritur nga institucionet paraqesin disa simptome specifike, prej të cilave më e dukshme është nevoja për vëmendje dhe varësia.

“Një djalë i rritur në institucion kishte marrëdhënie të ndryshme disfunksionale të varura me shokët dhe afërmit. Ai kishte nevojë për kontakt fizik me shokët duke u qëndruar shumë pranë, duke i prekur dhe duke i përqaftuar. Ai fliste gjithashtu për probleme në marrëdhëniet e tij ndërpersonale dhe paaftësinë për t’u larguar nga këto marrëdhënie, kur ishte e nevojshme.”

Në rastin e meshkujve të rritur, vështirësitë psikologjike lidheshin kryesisht me traumat e pësuar gjatë trafikimit dhe me zhgënjimin nga mospërmbushja e pritshëmive nga emigracioni apo përvoja e punës.

“Njëri prej meshkujve të shfrytëzuar për punë të detyruar në Afrikë në Afrikë tregon se për dy vjet ishte kuruar me anti-depresantë.”

Një shenjë tjetër e dëmit psikologjik të meshkujve të rritur ishte frika se shfrytëzuesit mund të lëndojnë ata vetë ose familjet e tyre. Dy rastet e huaja të asistuar treguan shenja të frikës së madhe gjatë qëndrimit në Shqipëri. Zakonisht, qëndronin në apartament dhe nuk donin të lëviznin nëpër Tiranë, nga frika se shfrytëzuesit mund t’i gjenin. Gjithashtu, burri shqiptar i trafikuar për punë të detyruar tha se vazhdimisht kishte frikë mos i ndodhte ndonjë gjë e keqe atij apo familjes.

Një tjetër vështirësi e hasur nga meshkujve të rritur është zhgënjimi me të cilin përballen kur kthehen pranë familjes. Një prej tyre u shpreh:

“Kthimi nga andej ishte shumë i vështirë. Nuk kisha para, isha i sëmurë me malarie dhe e dërgova bashkëshorten te prindërit, nuk kishim para të përballonim jetën. Pavarësisht nga kjo, një nga çastet më të vështira ishte kur vajza më kërkoi ta merrja në krahë e ta përkëdhelja e unë nuk mundesha, për shkak të dëmtimit të tendinave.”

Gjithashtu, njëri prej viktimave të huaja ishte në dyshim a të kthehej apo jo në vendin e origjinës. Ai ndihej i turpëruar para familjes nga kjo histori e pasuksesshme migrimi dhe sepse nuk kishte fituar mjaftueshëm për të dërguar disa para pranë familjes.

8.4 Ndhimja mjekësore

Ndhimja mjekësore është gjithashtu shumë e vlefshme, sidomos gjatë fazës së rehabilitimit.

Intervistat me profesionistët tregojnë se shumë prej rasteve kanë nevojë për ndihmë mjekësore në fillim të procesit të ri-integrimit. Kjo është si pasojë e procesit të trafikimit. Në të njëjtën kohë, shumë prej rasteve viktime të trafikimit vijnë nga familje të varfra dhe nuk kishin pasur aspak ose akses minimal në shërbime mjekësore më parë. Kjo mungesë ka ardhur për shumë arsye. Në Shqipëri, sektori i shëndetit publik nuk është lehtësisht i arritshëm, sidomos nëse dikush vjen nga një rajon tjetër dhe jeton në një rajon tjetër. Gjithashtu, nuk ka rimbursim të plotë të mjekimeve edhe kur dikush është pjesë e skemave të mbrojtjes sociale. Kjo e ka vështirësuar plotësimin e nevojave mjekësore për djemtë para se të hynin në programin e ri-integrimit. Një arsye tjetër madhore është se ata vijnë nga familje me të ardhura të ulëta ku nevojat shëndetësore për fat të keq janë shpërfillur, si pasojë e përparësive për nevojat të mbijetesës. Sipas menaxherëve të rasteve, shumë prej prindërve dhe vëllezërve a motrave të djemve vuajnë nga sëmundje të ndryshme si hipertensioni, sëmundje zemre, astma, depresion madhor, sëmundje të mushkërive (tuberkuloz, bronkopneumoni) ndonëse në moshë shumë të re. Ky model është transmetuar shpesh te djemtë, të cilët i neglizhojnë nevojat mjekësore dhe kujdesen vetëm pasi sëmundja ka përparuar dhe i pengon në jetën e përditshme.

Një arsye tjetër që pengon kujdesin mjekësor është shkalla e lartë e paragjykitimit dhe diskriminimit ndaj disa komuniteteve si ai rom dhe egjiptian. Një nga menaxherët e rasteve tregon se njëherë, kur shoqëronte një prej djemve të komunitetit rom dhe egjiptian, për shkak të disa lëndimeve nga një incident me biçikletë, mjeku rezistoi ta vizitonte, duke thënë që ishte i pisët.

Një pjesë e atyre që janë shfrytëzuar seksualisht përballen me probleme nga infeksionet seksuale, të cilat duhet të trajtohen shpejt në mënyrë që të parandalohen ndërlikime afatgjata. Është shumë e vështirë për djemtë që të kërkojnë ndihmë në lidhje me abuzimin. Një prej djemve ishte shfrytëzuar për qëllime seksuale po që rezistonte të fliste për shfrytëzimin seksual, donte të bënte analizat për HIV AIDS dhe ishte shumë në ankth në pritje të rezultateve. Kur e pyetën në ç'mënyrë mund të ishte infektuar me AIDS, ai foli për frikën e marrjes së AIDS kur kishte qenë te dentisti apo kur kishte qenë në spital për një problem.

Në raste të tjera kërkonin ndihmë mjekësore vetëm pasi kishin ndarë përvojën e shfrytëzimit seksual.

Gjithashtu, forma të tjera të simptomave mjekësore të manifestuara gjatë procesit të ri-integrimit janë imuniteti i dobët (për shkak të kushteve të papërshtatshme në të cilat kishin jetuar më parë), dhimbje koke kronike, infeksion urinar, probleme dentale dhe probleme me shikimin.

Një prej rasteve të intervistuar për këtë studim, përmendi shumë situata të dhunës fizike si mënyrë për t'i mbajtur nën kontroll ata që punonin në ndërtim. Por edhe pasojat fizike si rredhojë e dhunës së drejtpërdrejtë ndaj tyre. Në rastin e tij, si pasojë e dhunës së drejtpërdrejtë nga një truprojë e punëdhënësit, tendinat e shpatullës u dëmtuan dhe vuan pasojat edhe sot, pas dy vjetësh.

8.5 Ndhimja ligjore

Ka një mori çështjesh të lidhura me ndihmën ligjore. Së pari, të gjithë kanë nevojë për vlerësim ligjor në lidhje me çështjet që duhen ndjekur. Pjesa më e madhe e djemve kanë nevojë të ndihmohen menjëherë pasi kanë hyrë në programin e ndihmës, për dokumente identiteti dhe të tjera dokumente bazë që u mungojnë.

Disa prej djemve, përballen me çështje që lidhen me trafikuesit dhe procesin e shfrytëzimit. Në disa raste, ata kanë nevojë për ndihmë ligjore për mosdënimin për krimet që kanë kryer nën detyrimin e shfrytëzuesve. Për fat të keq, dy prej tyre që u shfrytëzuan për kriminalitet të detyruar u dënuan.

Analiza e rasteve të D&E tregon se tre raste kishin nevojë për urdhër mbrojtjeje nga prindërit.

8.6 Arsimimi, shkollimi dhe trajnimi profesional

Shumë prej djemve të asistuar nëpërmjet procesit të ri-integrimit e kishin ndërprerë shkollën në moshë të vogël. Nga ana tjetër, situata ndryshon për të rriturit e trafikuar për punë të detyruar. Ata zakonisht kishin përfunduar arsimin e mesëm, madje në vitet e fundit ishin përqendruar te arsimit profesional.

Pjesa më e madhe e djemve në situatë rruge e shohin shkollën si diçka që i takon së shkuarës, apo si diçka e humbur përfundimisht. Ka shumë pengesa që ndikojnë në vështirësinë e tyre për t'u rifutur në shkollë. Në disa raste, është analfabetizmi që i pengon të rikthehen në shkollë. Në raste të tjera, programet aktuale të rikuperimit akademik duken të papërshtatshme për ta, sepse kanë një shkrimje midis personave me moshë të ndryshme, për shembull 11 dhe 19 vjeçar.

Menaxherët e rasteve të intervistuar raportojnë se gjithsesi kur mundën të vazhdojnë apo të rikthehen në shkollë ka një ndikim pozitiv tek ata. ***Njëri nga djemtë e përsëriti vitin e fundit të shkollës 9 vjeçare për herë të dytë, pasi e kishte lënë shkollën ngaqë kishte përfunduar në situatë rruge. Kur u diplomua, u ndje i kënaqur dhe më i sigurtë në vetvete.***

Mungesa e aftësive për shkrim dhe lexim dhe për veprime me numrat ndikojnë në aftësinë e tyre për të gjetur punë të përshtatshme dhe të paguara mjaftueshëm. Për disa prej tyre është e vështirë edhe të ndjekin trajnime profesionale. Ata fillojnë një kurs profesional që në fillim u duket interesant, por pas pak kohësh, mund ta braktisin. Disa prej arsyeve më të zakonshme që e lënë kursin janë vështirësitë për për t'u bashkuar me kursantët e tjerë për shkak të stigmës sidomos kur djemtë vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian. Vështirësitë në shkrim e lexim apo analfabetizmi është një tjetër faktor që e vështirëson vazhdimësinë e kursit. Shpesh ndihen të turpëruar kur profesori apo kursantët e tjerë e marrin vesh këtë fakt. ***Njëri prej djemve e la kursin për zdrukthtari, dy javë pasi e kishte filluar, sepse "u ndje në siklet kur instruktori i tha të shkruante diçka dhe ai nuk dinte si ta shkruante."*** - Menaxher i rastit i D&E

Gjithashtu, vështirësitë për t'i shkuar planit deri në fund (do të shpjegohen në pjesën që flet për aftësitë e jetës) është një arsye tjetër që i çon drejt braktisjes së kursit.

Si u shpjegua më lart, te meshkujt e rritur të shfrytëzuar për punë të detyruar, niveli i arsimimit është më i lartë krahasuar me djemtë VeT dhe të rriturit kanë madje edhe kualifikime profesionale.

8.7 Ndhimja për punësim

Profesionistët e intervistuar shprehen se një prej pjesëve më sfiduese, në të njëjtën kohë edhe më interesante, në procesin e ri-integrimit është ndërmjetësimi dhe ndihma për punësim. Punësimi i qëndrueshëm mund të ndihmojë në procesin e ri-integrimit dhe është thelbësor për parandalimin e ri-viktimizimit.

Ofruesit e shërbimve thonë se vështirësitë e vërejtura gjatë këtij proces mund të grupohen në faktorë të jashtëm dhe faktorë të brendshëm.

Ndër faktorët e jashtëm, mund të thuhet se tregu shqiptar i punës nuk ofron shumë mundësi. Shumë të rinj nuk arrijnë të gjejnë punë, ose edhe kur e gjejnë, në të shumtën e rasteve, nuk është e përshtatshme për pritshmëritë e tyre. Një pjesë e madhe e tregut vijon të jetë informale dhe pagat minimale janë shumë të ulëta dhe në disa raste të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e jetesës. Një rast thotë: “Zyra e punësimit zakonisht nuk është një vend ku mund të gësh zgjidhje, nëse të duhet një punë”.

Pavarësisht nga disa përpjekje, nuk ka politika të qarta dhe praktike qeveritare për të nxitur përfshirjen në tregun e punës të grupeve vulnerabil të targetuara, si për shembull viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Përveç kësaj, vetë rastet kanë vështirësi të brendshme personale në lidhje me punësimin që ka ndikim tek ta. Sipas njërit prej menaxherëve të rasteve, vihet re veçanërisht në fillim të procesit se kanë plane të mëdha, ide të paqarta apo pritshmëri jorealiste për ç’ka mund të jetë profesioni i tyre në të ardhmen. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit se kur fillojnë procesin e ri-integrimit, nuk kanë qenë pjesë e tregut të rregulluar të punës, për shkak të situatës së shfrytëzimit.

Edhe kur fillojnë një punë, nuk është e lehtë për disa raste ta mbajnë atë punë për një kohë të gjatë. Kjo për shumë faktorë. Disa prej tyre kanë vështirësi në ruajtjen e marrëdhënive të qëndrueshme me kolegët apo eprorët. Të tjerë që kanë jetuar në situatë rruge për kohë të gjatë e kanë të vështirë të mësohen me rutinën e punës, oraret etj. Kjo është e kuptueshme duke marrë parasysh faktin se kanë jetuar për 15-16 vjet pa një strukturë të qartë në jetën e tyre.

Pavaërisht nga vështirësitë, ka pasur përpjekje të mëdha nga ofruesi i shërbimit për t’i përfshirë burrat dhe djemtë viktimat të trafikimit në tregun formal të punës.

Në rastin e meshkujve të rritur viktimat të trafikimit, situata e punësimit është ndryshe. Njëri prej meshkujve të trafikuar nuk mund të punonte më në ndërtim për

shkak të dëmtimit të tendinave. Ai ndihej keq për këtë. Ky është një shembull klasik i asaj që mund të shkaktojë përvojat e trafikimit.

Megjithatë, duke pasur parasysh se rastet e meshkujve të rritur ishin profesionistë të kualifikuar, dhe po përpiqeshin të gjenin mundësi më të mira punësimi se sa ato të ofruara në vnedin e origjinës, aktualisht në Shqipëri nuk ka shumë oferta pune për këtë kategori dhe politikat aktuale të punësimit në Shqipëri nuk e përfshijnë këtë kategori në mënyrë specifike.

Nga 19 burrat dhe djemtë në moshë dhe kushte për punë, 12 janë aktualisht duke punuar dhe 4 të tjerë kanë provuar punë të ndryshme dhe janë akoma duke kërkuar punën e duhur.

8.8 Rritja e aftësive për jetën dhe plotësimi i nevojave sociale

Në rastin e djemve të trafikuar që kanë qenë në situatë rruge për kohë të gjatë, ka shumë çështje që lidhen me aftësitë për jetën. Në disa nga rastet që kanë qenë në situatë të pastrehë për një kohë të gjatë, janë vërejtur disa vështirësi për kujdesin ndaj vetes. Situata dhe mjedisi të disavantazhit ekstrem i ka bërë shumë të rëndësishme aftësitë e mbijetesës dhe më pak ato për kujdesin ndaj vetes, si për shembull higjiena personale apo paraqitja e jashtme. Të duan veten, të kujdesen për veten dhe të gjejnë kuptim në atë që bëjnë është një temë me rëndësi parësore në të gjithë procesin e integritimit.

Aftësi praktike për jetën

Disa prej gjërave që duhen trajtuar janë ato që mund të quhen si **aftësi praktike për jetën**. Një çështje ku shumë prej djemve viktime të trafikimit hasin vështirësi janë aftësitë për buxhetim. Kjo vjen kryesisht nga mungesa e modeleve eficiente për administrimin e parave; në shumë raste, familjet e tyre jetojnë nën nivelin mesatar ekonomik dhe në disa raste prindërit janë përballur me varësinë nga alkooli apo kumari. Gjithashtu, buxheti kërkon planifikim afatgjatë, gjë që nuk është e lehtë për djemtë që kanë mësuar (nga historia e tyre) si të mbijetojnë sot dhe jo çfarë të presin nesër.

Mungesa e aftësive për veprime me numrat në disa raste ka ndikim edhe në aftësitë për buxhetim. Një prej djemve thotë: ***“Njëherë po diskutoja me një punëdhënës për mundësinë e punësimit në ndërtim. Ai më tha se do të më paguante 15.000 lekë për muaj dhe unë e pyeta ‘A mund të më thuash sa do të fitoj në ditë, sepse nuk e kuptoj sa është kur flet për rrogë mujore’.***

Pjesa më e madhe e rasteve kanë aftësi shumë të mira negociuese dhe mund të gjejnë zgjidhje praktike dhe kreative për problemet, por disa herë e kanë të vështirë t'i shkojnë një plani deri në fund.

Koncepti për veten

Një pjesë tjetër e rëndësishme e aftësive për jetën është koncepti për veten. Sikur se e kemi përmendur më lart, janë shumë faktorë që kanë patur rol të rëndësishëm në perceptimin e tyre për veten. Shpesh në rastet e shfrytëzuara për qëllime seksuale në moshë të vogël dhe që kanë qenë më parë në situatë rruge, koncepti i tyre për veten ndikohet nga përvoja e abuzimit dhe shfrytëzimit si dhe nga marrëdhëniet parësore me dhënësit e kujdesit. Një prej djemve që ishte braktisur nga prindërit, beson se të gjithë në fund do ta braktisin dhe ka një nevojë të madhe për t'u pranuar dhe miratuar nga të tjerët. Shfrytëzimi seksual shkakton shpesh ndjenja faji sepse ata besojnë që ishte përgjegjësia e tyre që u shfrytëzuan, edhe pse kanë qenë në situatë rruge ose në situata vulnerabël kur ka ndodhur shfrytëzimi. Në disa raste, ata janë torturuar nga frika se mund të jenë homoseksualë apo se dikush mund të marrë vesh se ata janë abuzuar seksualisht.

Marrëdhëniet sociale

Profesionistët e intervistuar shprehen se edhe marrëdhëniet sociale janë shumë të rëndësishme. Fëmijët që kanë qenë për një kohë të gjatë në situatë rruge parapëlqejnë të socializohen me persona të ngjashëm. Ata tregojnë shumë mbështetje dhe besnikëri ndaj njeri tjetrit. Tregojnë se kur kanë qenë në situatë rruge kanë ndarë edhe copën e bukës me shokë të tjerë në të njëjtën situatë. Për ata, miqësia është e rëndësishme dhe e vlerësojnë shumë këtë fakt.

Edhe për djemtë e rinj të vendosur në institucione, miqësia është një vlerë e rëndësishme. Shpesh, kjo nevojë për miq shoqërohet me ndjenja zilie kur perceptojnë se miqtë e tyre po marrin më shumë vëmendje, mbështetje, apo shërbime nga profesionistët. Kjo mund të lidhet me ngrohtësinë dhe mbështetjen e kushtëzuar që kanë marrë në institucione, si dhe me faktin se u është dashur të konkurrojnë për vëmendjen e numrit të kufizuar të kujdestarëve, që do të thotë se u duhej të konkurronin për të njëjtat burime të kufizuara vëmendjeje, ngrohtësie dhe mbështetjeje. Në të njëjtën kohë, dëshirat dhe ëndërrat e tyre më të mëdha tregojnë se janë shumë të interesuar të ndihmojnë të tjerët, veçanërisht fëmijët në situata të ngjashme. Sipas njërit prej menaxherëve të rasteve të D&E, njëri nga djemtë ëndërronte të bëhej i pasur e të ndihmonte fëmijët e braktisur në institucione apo në situatë rruge. Ai vetë kishte qenë në situatë rruge dhe në institucion për pjesën më të madhe të 18 viteve të tij. Këto lloj përfytyrimesh gjenden shpesh te fëmijët që kanë qenë në situatë rruge apo të vendosur në institucione.

Plotësimi i nevojave sociale

Përvoja e ofruesve të shërbimeve tregon se **plotësimi i nevojave sociale** të djemve të trafikuar ka rëndësi tejet të madhe. Një nga mundësitë konkrete që ndihmon në plotësimin e këtyre nevojave janë kurset e ndryshme me fokus te hobi që kanë (jo domosdoshmërisht trajnime profesionale). Nga përvoja e ofruesve të shërbimeve, kjo është veçanërisht e rëndësishme për grupin e djemve 16-18 vjeç, meqenëse veprimtari të tilla u pëlqejnë shumë, rrisin vetëvlerësimin, përmirësojnë aftësitë sociale dhe shërbejnë si një kalim i shëndetshëm i kohës përkundër veprimtarive të pashëndetshme që kanë mësuar gjatë kohës kur kanë qenë në situatë rruge apo në proces shfrytëzimi, si përshebull luajtja e pakontrolluar kumarit, tymosja e cigares, apo përdorimi i drogave të tjera, apo pjesëmarrje në qarqe sociale të dëmshme..

8.9 Ndërmjetësimi me familjen dhe ndërhyrja

Sikur u vu në dukje në paragrafët më lart, në shumë raste, familjet e viktimave meshkuj të trafikimit janë jofunksionale dhe shpesh përballen me dhunë dhe abuzim. Megjithatë, nga përvoja e menaxherëve të rasteve të intervistuar, puna me familjen (kur është e mundur), mund të jetë ndihmë e madhe për procesin e ri-ntegrimit të të mbijetuarit.

Sipsa përvojës së tyre, procesi i ri-integrimit për ato raste që kanë mundur të ripajtohen me familjet ishte më i lehtë dhe më i efektshëm, krahasuar me ata që u asistuan pa bashkëpunimin e familjes. Mbështetja e familjes duket të ndihmojë për një proces ri-integrimi më të shpejtë, një proces më të qëndrueshëm dhe i ka asistuar këta meshkuj të rikuperojnë në aspekte të ndryshme në të njëjtën kohë.

Menaxherët e intervistuar të rasteve sugjerojnë që, sidomos kur viktimat e trafikimit janë të mitur, puna me viktimën dhe puna me familjen duhet të konsiderohet si e pandarë. Kështu, në pjesën më të madhe të rasteve, nëse puna përqendrohet vetëm tek i mbijetuari, nuk mjafton për të sjellë ndryshim; ndërhyrja duhet të përfshijë strukturat e familjes. Disa herë, ka struktura të thella të familjes që janë të vështira për t'u ndryshuar. Në shumë raste, ka trauma dhe mosfunksionime ndër breza, të cilat duhet të trajtohen e të zgjidhen.

Për shembull, familjet e atyre që janë shfrytëzuar për lypje kanë edhe anëtarë të tjerë të familjes që janë të përfshirë në lypje. Prandaj, është e nevojshme të thyhet rrethi i abuzimit dhe mosfunksionimit dhe të nxitet fuqizimi nëpërmjet shërbimeve të ofruara. Për këtë arsye, fokusi i menaxhimit të rastit nuk duhet të jetë vetëm mbi personin që ka qenë viktimë e trafikimit, por edhe mbi familjen si një strukturë e tërë. Ofruesit e shërbimeve shprehen se ndërmjetësimi për punësim, këshillim

psikosocial dhe referimi në shërbime të ndryshme kanë qenë disa nga shërbimet më të zakonshme për familjen e viktimave meshkuj të trafikimit. Familjet janë konsideruar edhe si përfitues dytësore, pasi mirëqenia e familjes ka ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e përgjithshme të meshkujve të shfrytëzuar.

Sipas menaxherit të rastit nga D&E, pesë djem morën ndihmë si fillim në apartamente me qira dhe më pas në familje, pas negociatave me familjet. Edhe në ato raste, faza e dytë e ndërhyrjes ishte më e efektshme.

Duhet nënvizuar se në pjesën më të madhe të rasteve, pjesëtarët e tjerë të familjes nuk kanë dijeni për përvojat e trafikimit. Kjo vjen kryesisht për faktin se të mbijetuarit zgjedhin të mos flasin për përvojën e tyre, duke e konsideruar diçka për të cilën ndiejnë turp, ose diçka që mund të përkeqësojë marrëdhëniet me familjen. I druhen mohimit apo refuzimit nga familjarët.

Si konkluzion, puna me strukturat e familjes dhe fuqizimi i tyre është një instrument ndihmës për ri-integrimin dhe parandalimin e rivikimizimit, kur është e mundur dhe kur familja nuk është shkak i drejtpërdrejt i proçesit të trafikimit.

8.10 Asistenca për fëmijët apo motrat dhe vëllezërit e VeT

Pjesa më e madhe e rasteve të asistuarra kanë qenë meshkuj në moshë të re dhe nuk kanë pasur fëmijë; megjithatë, në rastet e asistuarra ka qenë e rëndësishme që të parandalohej dhe thyej zinxhiri i abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit. Siç u nënvizua më lart, në shumë raste, disa forma të shfrytëzimit, si për shembull lypja, ka vazhduar për dy apo tre breza. Prandaj, është e rëndësishme që fëmijët viktimë të trafikimit të shihen si një mënyrë për të parandaluar rrezikun e shfrytëzimit në të ardhmen.

Një tjetër çështje e rëndësishme është ndihma e ofruar për vëllezërit dhe motrat e djemve viktimë të trafikut të qenieve njerëzore. Siç u shpjegua më lart, shumë prej fëmijëve dhe djemve që janë trafikuar kanë jetuar në familje të varfra apo jofunksionale, abuzimi dhe neglizhimi kanë qenë të pranishëm. Në këtë mënyrë, jo vetëm ata që janë trafikuar, por edhe motrat dhe vëllezërit e tjerë kanë vuajtur nga të njëjtat kushte familjare dhe sociale.

Në rastin e viktimave të trafikimit meshkuj të rritur, marrëdhënia me fëmijët ka rëndësi tejet të madhe për ta. Në mënyrë që të mbështeten plotësisht nga ofruesit e shërbimeve, nevojitet që të asistohen edhe fëmijët e tyre.

9. Sfidat në dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit meshkuj

Sipas intervistave dhe përvojës së ofruesve të shërbimit, disa nga pengesat e hasura për dhënien e ndihmës viktimave meshkuj të trafikimit përfshijnë:

- Mospërputhje midis nevojave të VeT dhe shërbimeve të ofruara nga shërbimet sociale;
- Programe ri-integrimit të hartuara dhe të strukturuar për VeT femra dhe fëmijë, por jo për VeT meshkuj;
- Mbivendosje midis çështjeve të trafikimit të të miturve dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Vështirësi nga viktimat meshkuj të trafikimit për të kërkuar ndihmë për shkak të historisë dhe çështjeve personale;
- Vështirësi në gjetjen e akomodimit për meshkujt në nevojë urgjente.

Përvoja e D&E në dhënien e ndihmesës për meshkujt e trafikuar në Shqipëri që prej vitit 2012 tregon se nevojat për ndihmë të meshkujve të trafikuar janë: këshillim psiko-social; ndihmë ligjore; ndihmë mjekësore; mbështetje për të gjetur punë; mbështetje financiare për të paguar qiranë e apartamentit; trajnim për të rritur aftësitë për jetën; informacion dhe shërbime ndërmjetësimi nga ofrues të ndryshëm shërbimesh në komunitet, monitorim dhe ndjekje e rastit, etj.

Asistenca e viktimave të trafikimit është një prej aspekteve më kuptimplota dhe më të rëndësishme të përpjekjeve anti-trafik. Përveç mbështetjes në procesin e rikuperimit dhe ri-integrimit të viktimave të trafikimit, ndihmon në vendosjen e drejtësisë dhe rikthimin e besimit të viktimës në sistem dhe shoqëri. Gjithashtu, është mënyra më e mirë për të parandaluar riviktimizimin e të mbijetuarve.

Analiza e literaturës dhe intervistat informojnë se janë bërë hapa para në lidhje me asistencën për viktimat e trafikimit, përfshirë krijimin e strehëzave, standardet për kujdes rezidencial, kuadrin ligjor, ndihmësën ligjore, mirëqenien sociale, etj. Gjithsesi, kontributi i shtetit ka qenë minimal; barra e asistencës rëndon mbi shoqërinë civile dhe donatorët dhe rreziku i ndërprerjes nga ana e këtyre aktorëve mbetet gjithmonë i pranishëm.

Sistemi i mirëqenies sociale në Shqipëri ka shumë hendeqe dhe nuk mund të gjejë zgjidhje të qëndrueshme për disa prej nevojave bazë të viktimave meshkuj të trafikimit. Për shembull, ashtu si u citua në paragrafët për identifikimin dhe asistencën, duke qenë në situatë rruge, të miturit dhe të rinjtë mund të bien më vonë në një situatë shfrytëzimi.

Në shumë raste, ofruesit e shërbimeve (në pjesën më të madhe OJF) e gjejnë veten të vetëm ose jo të mbështetur plotësisht në përpjekjet e tyre për të asistuar vikimat meshkuj të trafikimit në procesin e ri-integrimit. Kështu, është e vështirë për vikimat e trafikimit të gjejnë punë nëpërmjet zyrave të punësimit, apo të përfitojnë nga sistemi i banesave sociale. Sigurimi i apartamenteve me qira, është një shërbim i mirë i përkohshëm, por nuk përmbush nevojën për akomodim afatgjatë.

Trajnimet profesionale nuk janë gjithmonë të përshtatshme për vikimat meshkuj të trafikimit, të cilët e kanë më të lehtë të mësuarit praktik, krahasuar me atë teorik. Tregu i punës është i kufizuar, sidomos për meshkujt 18-30 vjeç dhe kompanitë nuk kanë të rregulluara mirëfilli politika për përgjegjësinë sociale të biznesit.

Pavarësisht nga disa përpjekje, sistemi i kujdesit shëndetësor nuk siguron ende ndihmë mjekësore falas për vikimat e trafikimit. Ndihma mjekësore për vikimat meshkuj të trafikimit është tepër e kushtueshme, po të kemi parasysh pasojat në shëndet nga shfrytëzimi dhe mjedisin e pafavorshëm në të cilin kishin jetuar më parë.

Përveç sfidave në praktikën e përgjithshme të punës me vikimat e trafikimit, kur bëhet fjalë për burrat viktimë të trafikimit ka disa pengesa të tjera specifike, që lidhen si me vetë ata edhe me mangësitë në sistem.

Në shumë raste, djemtë dhe burrat e trafikuar e kanë të vështirë t'u besojnë të tjerëve, përfshirë ofruesit e shërbimeve në disa situata. Ky mosbesim vjen si pasojë e përvojave negative që kanë pësuar duke u besuar të tjerëve dhe në fund janë mashtruar. Sipas njërit prej menaxherëve të rasteve në D&E, **njëri nga djemtë nuk pranoi të nënshkruante dokumentet e nevojshme për të hyrë në programin e asistencës, sepse, sipas tij, e kishin mashtruar shumë herë dhe nuk donte të bënte të njëjtin gabim përsëri.** U nevojiten të paktën tre takime me të, në mënyrë që të ndërtohej besimi dhe të fillonte procesi i asistencës. Ndërtimi i besimit me djemtë që janë rritur në familje abuzive apo shfrytëzuese është edhe më i vështirë. Nevojitet kohë, durim dhe shumë empati për të ndërtuar marrëdhënie besimi.

Njëri prej menaxherëve të rasteve thotë se për shkak të skemave sociale, disa herë **është e vështirë për meshkujt të pranojnë që janë vulnerabël, dhe që kanë nevojë për ndihmë dhe asistencë.** Për shembull, është e vështirë për djemtë dhe burrat viktimë të trafikimit të ndjekin seanca këshillimi, edhe kur mundohen e luftojnë me çështje serioze psikologjike.

Një sfidë tjetër është vështirësia për të planifikuar. Për shkak të mjedisit të pafavorëshëm ku janë rritur dhe të traumave të shoqëruara me procesin e trafikimit, djemtë viktimë të trafikimit e kanë të vështirë të ndërtojnë plane të qarta dhe realiste si dhe t'u shkojnë atyre planeve deri në fund. Në pjesën më të madhe të rasteve, ata kanë plane të mëdha dhe jorealiste dhe hasin vështirësi kur u nevojitet durim dhe të presin nën stres. Kjo gjendje i vështirëson marrëdhëniet e tyre, sidomos për të gjetur stabilitet në vendin e punës.

Përsa u përket meshkujve të rritur viktimë të trafikimit, ku vetëm tre persona janë identifikuar, çështja qëndrore mbetet mungesa e identifikimit nga ana e agjencive.

Një çështje tjetër mund të jetë vështirësia që kanë vetë personat për të kërkuar ndihmë dhe ta konsiderojnë veten si persona të cilëve u janë shkelur të drejtat e njeriut. Siç është shpjeguar në kapitujt e mëparshëm të këtij materiali, kjo vështirësi mund të lidhet me perceptimin e vulnerabilitetit përkundrejt skemave të burrërisë.

Një pengesë tjetër madhore për ndihmën ndaj viktimave meshkuj lidhet me faktin se asistencë është e projektuar për gra dhe vajza të trafikuar.

Kjo do të thotë se disa forma të ndihmësës – p.sh. strehëzat e përkohshme apo akomodimi afatgjatë – nuk ofrohet për burrat dhe djemtë.

Sipas një informuesi nga Shqipëria me përvojë në rastet e femrave dhe fëmijëve viktimë të trafikimit, *“legjislacioni shqiptar natyrisht i ka dhenë përparësi grave dhe fëmijëve, pasi këto kategori në më të shumtën e rasteve janë në pozita më të dobëta fizike dhe sociale se meshkujt; për rrjedhojë, janë edhe më të ekspozuara ndaj trafikimit. Gjithashtu, pasojat fizike, psikologjike dhe sociale nga trafikimi i fëmijëve dhe femrave janë më të rënda në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.”*

10. Përfundime dhe rekomandime

Ky material hedh dritë mbi çështjen e trafikimit të burrave dhe djemve dhe në këtë mënyrë, ka identifikuar një grup personash që janë aktualisht të trajtuar nën atë që pritet, pa asistencë apo nën nivelin e duhur të asistencës. Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe KiE është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet më shumë vëmendje për të kuptuar dhe trajtuar nevojat e burrave dhe djemve të trafikuar në Shqipëri, drejt Shqipërisë apo nëpërmjet Shqipërisë. Rekomandimet e mëposhtme janë bërë për të hedhur hapa përpara për një reagim dhe asistencë më të efektshme për viktimat e meshkuj të trafikimit në Shqipëri.

10.1 Identifikimi

- Ndërtimi i strukturave për identifikim proaktiv, të ngjashme me Njësitë Lëvizëse. Kjo qasje ka përfitim të dyfishtë: së pari, ofruesit e shërbimeve kalojnë nga pozicioni reagues në pozicionin proaktiv për identifikimin; qasja proaktive mund të rrisë kapacitetet e identifikimit në mikrokomunitete, duke siguruar struktura identifikimi të qëndrueshme edhe kur strukturat proaktive nuk do të ekzistojnë më në atë komunitet;
- Trajnim i mëtejshëm për personelin në pikat e kalimit të kufirit, me fokus te trafikimi i meshkujve për punë të detyruar ose veprimtari kriminale;
- Hulumtim për të kuptuar më mirë vulnerabilitetin e meshkujve dhe trajtat e shprehjes së këtij vulnerabiliteti;
- Analizim më i mirë i migrantëve për të vlerësuar nëse janë raste të trafikimit;
- Shembja e imazhit dhe perceptimit kulturor se djemtë dhe burrat nuk janë vulnerabël;
- Përfshirje e mëtejshme e inspektorëve të punës për identifikimin proaktiv të VeT potencial, sidomos në sektorin e ndërtimit dhe atë të bujqësisë;
- Trajnim i personelit të zyrave të punësimit dhe të OJF-ve që punojnë me migrantët e kthyer, për të vlerësuar nëse ka tregues të shfrytëzimit apo trafikimit te migrantët e kthyer;

- Trajnimi i njësive për mbrojtjen e fëmijëve, psikologëve të shkollave, oficerët antitrafik dhe të policisë të sektorit të të miturve, si dhe struktura të tjera që punojnë me të miturit në situata vulnerabël, për të identifikuar situata të mundshme të shfrytëzimit seksual, lypjes së detyruar apo shfrytëzimit për veprimtari kriminale;
- Veprimtari ndërgjegjësuere, sidomos për grupet e targetuara në *rrezik shfrytëzimi dhe trafikimi*, të tilla si familje të varfra, komuniteti rom dhe egjiptian, apo punonjës në kushte të vështira pune. Kjo qasje mund të ndihmojë jo vetëm në procesin e identifikimit dhe referimit të rasteve, por edhe mund të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit për tregues të shfrytëzimit dhe trafikimit, duke parandaluar situata të ngjashme.
- Studime me fokus kryesor të trafikimi i meshkujve apo fusha të tjera që kanë lidhje me këtë, si meshkuj të rinj në situatë rruge, migrantë që kanë qëndruar në mënyrë të parregullt apo nuk kanë pasur sukses në historinë e tyre të migrimit, kriminaliteti të të miturit, kushtet e punës në ndërtim apo bujqësi;
- Fushata ndërgjegjësimi që i drejtohen publikut të gjerë nëpërmjet medias apo medias sociale në përpjekje për të ndryshuar stereotipet e shoqërisë dhe që të kuptohet se edhe burrat mund të jenë viktimat e trafikimit, dhe ç'ka është më e rëndësishmja është informimi për të drejtat e viktimave dhe se kjo nuk ka diçka për t'u pasur turp.

10.2 Asistenca

- **Përcaktimi i nevojës për asistencë të djemtë dhe burrat:** perceptimi kulturor se djemtë janë në gjendje të kujdesen për veten ndikon jo vetëm në mungesën e identifikimit por edhe në procesin e asistencës.
- **Asistenca afatgjatë:** Ky studim konfirmon faktin se procesi i ri-integrimit është një rrugë e gjatë e me kthesa. Rekomandimi është se çdo ofrues shërbimi duhet të marrë parasysh kohën e gjatë që nevojitet për ri-integrimin e burrave dhe djemve dhe, rrjedhimisht, duhet të planifikojë dhe të sigurojë burimet e nevojshme për këtë.
- **Përshatja e asistencës në bazë të nevojave individuale të të mbijetuarit:** TKjo është shumë e rëndësishme. Ofruesit e shërbimeve, donatorët, dhe institucionet shtetërore duhet të mbajnë parasysh se procesi i asistencës duhet të mbështetet në nevojat individuale. Ndaj, ofruesit e shërbimeve duhet të jenë në gjendje t'u ofrojnë viktimave meshkuj të trafikimit një larmi shërbimesh.

Intervistat me profesionistët tregojnë se, në përgjithësi, nevojat e grupit të djemve të mitur të trafikuar janë deri diku të ndryshme nga nevojat që kanë meshkujt e rritur të trafikuar.

- **Ndërhyrje e bazuar tek familja:** Intervistat me profesionistët e përfshirë në asistencën e meshkujve të trafikuar, analizimi i dosjeve të rasteve dhe hulumtime të bëra më herët tregojnë se procesi i ri-integrimit priret të jetë më i efektshëm kur ndërhyrjet në menaxhimin e rasteve përfshijnë edhe sistemin e familjes, dhe jo vetëm të mbijetuarin, sidomos në lidhje me këshillimi dhe fuqizimin ekonomik;
- **Mbështetje bazuar në komunitet:** Zgjerimi i asistencës për meshkujt në moshë madhore drejt komunitetit të tyre, sidomos kur kanë edhe familje, shihet si shumë e rëndësishme.
- **Qasja e fuqizimit:** Ka shumë rëndësi të theksohet rëndësia e një pakete të plotë shërbimi, si dhe të nënvizohet balanca e rëndësishme midis dhënies së shërbimit dhe inkurajimit të pavarësisë e fuqizimit.
- **Sistemi i mirëqenies sociale** duhet të përfshirje shërbime të tilla si strehimi, me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin nga shfrytëzimi për njerëzit vulnerabël, si dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë e ri-integrimit të meshkujve të trafikuar.

II. Referenca

- Vendim Nr. 582, datë 27.7.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit”
- Ministria e Brendshme (2006), *Analiza e punës së Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit gjatë vitit 2006 dhe detyrat për të ardhmen*, Ministria e Brendshme.
- Urdher i ministrit Nr. 1014 datë 30.5.2007 ‘Rregulla të veçanta për inspektorët dhe kontrolloret e punes. Gjendet në www.sli.gov.al
- Alquézar Sabadie, J., J. Avato, U. Bardak, F. Panzica & N. Popova, (2010) *Migration and skills: the experience of migrant workers from Albania, Egypt, Moldova, and Tunisia*, World Bank-European Training Foundation.
- Anti-Trafficking Monitoring Group (2010) *Wrong kind of victim? One year on: an analysis of UK measures to protect trafficked persons*, Anti-Slavery International. Gjendet te http://www.antislavery.org/includes/documents/cm_docs/2010/f/full_report.pdf
- Berman, Jacqueline, Donatella Bradic & Phil Marshal (2014) *Needs Assessment: Human Trafficking in the Western Balkans*, International Organization for Migration (IOM). Gjendet te http://www.albania.iom.int/publications/research/CT%20Resreach%20publication%20ENG_Web.pdf
- Bhabha, J. (2005) ‘Trafficking, Smuggling and Human Rights’, *Migration Policy Institute*, March 1. Gjendet te <http://www.migrationinformation.org/Feature/display.cfm?ID=294>
- Brunovskis, Anette & Rebecca Surtees (2010) ‘Untold Stories: Biases and Selection Effects in Research with Victims of Trafficking for Sexual Exploitation’, *International Migration Special Issue on Human Trafficking*, 48(4), 1-37.
- Eurostat (2013) *Trafficking in Human Beings*, European Commission. Gjendet te http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/2013/docs/20130415_thb_stats_report_en.pdf
- GRETA (2011) *Report concerning the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania, First evaluation round*.
- Hatziprokopiou (2003) ‘Albanian immigrants in Thessaloniki, Greece: processes of economic and social incorporation’, *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 29(6), 1033-1057. Gjendet te http://www.antigone.gr/en/library/files/selected_publications/greece/Albanian_immigrants_in_Thessaloniki.pdf
- ILO (2005) *A Global Alliance Against Forced Labour: Global Report under the Follow-up to the ILO Declaration on ‘Fundamental Principles and Rights at Work’*, Organizata Ndërkombëtare e Punës.
- Mario Project (2010) *Observation Report: Exploitation of Albanian Children in Street Situation in Kosovo, Protect Children on the Move*. Gjendet te: http://www.childtrafficking.com/Docs/tdh_10_kosova_original_0311.pdf

- Raport për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të personave, Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit në Njerëz.
- Roma, Giuseppe (2002) *Trafficking of human beings: methods and measures for defending and supporting the victims*, Centro Studi Investimenti Sociali (CENSIS), report presented at the European Conference on Preventing and Combatting Trafficking in Human Beings, Global challenge for the 21st century, Brussels, 18-20 September 2002.
- Rosenberg, Ruth (2010) *Trafficking of Adult Men in the Europe and Eurasia Region: Final Report*, USAID and Creative Associates International. Gjetet te: http://lastradainternational.org/Isidocs/Trafficking%20of%20Men%20Draft_final.pdf
- Sefa, Ersida (2009) *The Rights of Albanian Emigrants and Returnees in Albania*, Social Watch. Gjetet te: <http://www.socialwatch.eu/2009/documents/Albania.pdf>
- Surtees, Rebecca (2014) 'Another side of the story. Challenges in research with unidentified and unassisted trafficking victims', in Yea, Sallie (Ed.) *Human Trafficking in Asia: Forcing Issues*, Routledge.
- Surtees, Rebecca (2008) 'Trafficked Men as Unwilling Victims', *St Antony's International Review*, 4(1), 16-36.
- Surtees, Rebecca (2008) *Trafficking of men - a trend less considered. The case of Belarus and Ukraine*, International Organization for Migration. Gjetet te: <http://nexusinstitute.net/publications/pdfs/Trafficking%20in%20men%20-%20the%20case%20of%20Belarus%20&%20Ukraine,%20Surtees%202008.pdf>
- Surtees, Rebecca (2005) *Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe*, Regional Clearing Point, International Organization for Migration. Gjetet te http://publications.iom.int/bookstore/free/Second_Annual_Report2005.pdf
- Surtees, Rebecca & Sarah Craggs (2010) *Beneath the surface. Methodological issues in research and data collection with assisted trafficking victims*, IOM and NEXUS Institute.
- Strategji për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer 2010-2015 http://www.asp.gov.al/images/pdf/2011/strategji_riintegrim_shtetas.pdf
- Triandafyllidou, Anna (2010) *Irregular Migration in Europe: Myths and Realities*, Ashgate Publishing Research in Migration and Ethnic Relations Series.
- Triandafyllidou, Anna (2011) *Circular Migration and Integration: A Short Guide for Policy Makers*, METOIKOS Project, European University Institute. Gjetet te: <http://www.eui.eu/Projects/METOIKOS/Documents/GuidePolicyMakers/METOIKOSGuideforPolicyMakers.pdf>
- UNODC (2012) *Abuse of a position of vulnerability and other "means" within the definition of trafficking in persons*, UNODC Issue Paper.
- U.S. Department of State (2013) *Trafficking in Persons Report*, United States Department of State.

12. Shtojca

Projekt “Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri”

Formati i intervistës

Emri i agjensisë:

Kontakte:

Data e intervistës: Ora e intervistës:

Kategoria e personave të asistuar/ në fokus:

Shërbimet e ofruara:

Numri i personave të asistuar:

Numri i migrantëve: Migrant të parregullt? Migrant të rregullt?

Të dhëna mbi profilin e tyre: Moshë, arsimimi, prejardhja familjare?

Numri/ vlerësimi i atyre që gjenden në situatë shfrytëzuese:

Lloji i situatës shfrytëzuese:

Rastet e meshkujve të trafikuar midis rasteve të asistuar: (të rekrutuar, transportuar, shfrytëzuar)

Indikatorë/ instrumenta të përdorur për të identifikuar meshkujt e trafikuar:

Vendet e origjinës për personat në situatë shfrytëzimi dhe/ ose të trafikuar?

Vendet e destinacionit?

Llojet e punësimit/ shfrytëzimit?

Mënyra e largimit nga shfrytëzimi?

Shërbime të veçanta të ofruara nga agjensia për meshkujt e shfrytëzuar dhe/ ose trafikuar?

Referenca në legjislacion në lidhje me viktimat e trafikuar?

Sfidat në asistimin e meshkujve të trafikuar/ shfrytëzuar?

Rekomandime në identifikimin dhe referimin e meshkujve të trafikuar?

Rekomandime në asistimin e viktimave të trafikimit?

Rekomandime për burime të tjera informacionit?

Ndonjë rast specifik viktimash trafikimi që doni të referoni të D&E.

// E ndëruar Zotëri/ Zonjë,

Ju falenderojmë për kohën që do i kushtoni plotësimin të këtij pyetëso. Identiteti juaj ose identiteti i organizatës tuaj nuk do të bëhet i njohur në studim, përveç rasteve kur ju specifikisht e kërkonti këtë gjë. Edhe pse do të donim të kishim përgjigjet tuaja për çdo pyetje, jemi të vetdijshëm që për disa pyetje mund të mos keni informacion ose një opinion për të ndarë. Për këtë arsye vlerësojmë shumë kohën që do i kushtoni plotësimin të pyetjeve që ju duken të përshtatshme dhe kthimin mbrapsht të pyetësorit.

Emri i organizatës:

Adresa:

Fusha ku punon:

Përfituesit:

Emri dhe pozicioni i personit që plotëson pyetësoin:

1. Mendoni se legjislacioni i mëparshëm në vendin tuaj i ka dhënë më shumë rëndësi trafikimit të femrave dhe femijëve dhe më pak trafikimit të meshkujve? Nëse po, cilat mendoni kanë qenë arsyet?
2. Mendoni se legjislacioni aktual në vendin tuaj i jep aktualisht më shumë rëndësi trafikimit të femrave dhe femijëve dhe më pak trafikimit të meshkujve? Nëse po, cilat mendoni janë arsyet?
3. Cilët instrumenta / mjete të identifikimit të trafikimit të qenieve njerëzore keni përdorur më parë?
 - a. përpara 2011?
 - b. 2011 dhe më pas?
4. Kujt burimi/ strukture i jeni referuar më parë lidhur me monitorimin e identifikimit të viktimave të trafikimit në vend?
 - a. në të kaluarën (përpara 2011)
 - b. tani (2011 dhe pas)
5. Cfarë dini për numrin e viktimave të trafikimit përpara 2011?
 - a. Në Shqipëri (Viktima trafikimi shqiptare dhe të huaja)
 - b. Viktima shqiptare të trafikuar jashtë vendit /brenda vendit
6. Cfarë dini për numrin aktual të viktimave të trafikimit në Shqipëri(2011 dhe më pas)? Nëse mundeni, ju lutem përdorni tabelën më poshtë:⁴⁹:

⁴⁹ Ju lutem shkruani N/A nëse nuk keni informacion

Viktima në Shqipëri	Numri i viktimave shqiptare të trafikimit	Burimi i informacionit tuaj	Numri i viktimave të huaja	Burimi i informacionit tuaj
Fëmijë femra: 0- 10 vjeç				
Fëmijë meshkuj: 0- 10 vjeç				
Fëmijë femra 11- 14 vjeç				
Fëmijë meshkuj 11- 14 vjeç				
Fëmijë femra 15- 18 vjeç				
Fëmijë meshkuj 15- 18 vjeç				
Të rritur femra				
Të rritur meshkuj				
Totali ⁵⁰				

7. Çfarë dini për numrin aktual të viktimave (2011 dhe më pas) të trafikuar jashtë vendit /brenda vendit? Nëse mundeni, ju lutem përdorni tabelën më poshtë ⁵¹:

Viktima të trafikuar janë vendit	Numri i viktimave (për vitin 2012)	Burimi i informacionit	Vendi i shfrytëzimit (destinacion ose tranzit)
Fëmijë femra: 0- 10 vjeç			
Fëmijë meshkuj: 0- 10 vjeç			
Fëmijë femra 11- 14 vjeç			
Fëmijë meshkuj 11- 14 vjeç			
Fëmijë femra 15- 18 vjeç			
Fëmijë meshkuj 15- 18 vjeç			
Të rritur femra			
Të rritur meshkuj			
Totali ⁵²			

8. Cilat mendoni se janë arsyt që meshkujt viktimë të trafikimit (shqiptarë apo të huaj) nuk identifikohen në Shqipëri?

9. Në eksperiencën tuaj, si mund të dallohet një mashkull i trafikuar?

10. Në eksperiencën tuaj, në cilat kategori (shtresa, grupi) duhet fokusuar për identifikimin e një mashkulli të trafikuar?

⁵⁰ Ju lutem shkruani vetëm totalin nëse nuk i kategorizoni sipas moshës dhe gjinisë ose nëse burimi i informacionit nuk e ka specifikuar.

⁵¹ Ju lutem shkruani N/A nëse nuk keni informacion

⁵² Ju lutem shkruani totalin nëse nuk keni detaje mbi moshën.

11. Nëse njihni raste të meshkujve shqiptarë të trafikuar, a mund të përshkruani rrethanat e rekrutimit të rasteve të meshkujve shqiptarë të trafikuar?

12. Nëse njihni raste të meshkujve shqiptarë të trafikuar, a mund të përshkruani rrethanat e shfrytëzimit, llojin e punës ose shërbimit që kanë kryer?

- a. Viktima shqiptare në Shqipëri
- b. Viktima të huaja në Shqipëri
- c. Viktima shqiptare jashtë vendit

13. A njihni raste të dënimit të trafikantëve të viktimave meshkuj të trafikimit?

14. Nëse nuk njihni raste të meshkujve të trafikuar në Shqipëri, dini sesi meshkujt gjejnë punë:

- a. në Shqipëri in Albania (Meshkuj shqiptarë ose të huaj)?
- b. Jashtë vendit (Meshkujt shqiptarë)

15. A njihni raste në të cilat shteti shqiptar ka mbrojtur/ asistuar migrantët shqiptarë në situata vulnerable ose shfrytëzuese jashtë vendit? Nëse po, çfarë lloj mbrojtjeje/ asistence misionet diplomatike shqiptare kanë ofruar?

16. Si mendoni se janë sjellë vendet e destinacionit në lidhje me migrantët shqiptarë?

17. A mendoni se qëndrimi ndaj migrantëve ka lehtësuar apo penguar identifikimin e viktimave meshkuj të trafikimit?

18. A keni asistuar ndonjëherë viktima të trafikimit meshkuj? Shqiptarë apo të huaj, dhe në ç'formë?

19. A njihni raste të ofrimit të rehabilitimit dhe riintegrit për viktimat meshkuj të trafikimit? A mund t'i përshkruani ato shkurtimisht?

20. Çfarë rekomandime keni për asistimin e meshkujve viktima trafikimi?

21. Nëse jeni duke asistuar viktima të trafikimit meshkuj, çfarë ndihme do te donit nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, apo partnerët tanë në Shqipëri ?⁵³

22. Ju lutemi jepni ndonjë informacion shtesë në lidhje me trafikimin e meshkujve që konsideroni të rëndësishëm për studimin tonë, që nuk janë trajtuar në pyetjet e mësipërme.

JU FALENDEROJMË SHUMË DHE JU UROJMË SUKSESE NË PUNËN TUAJ!

⁵³ Nëse keni nevojë për mbështetje ju lutem kontaktoni D&E ose dërgoni një mesazh në adresën tonë.